



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR INFORMACION NË FUSHËN E MJEDIST DHE TURIZMIT

2022

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
1.	18/03/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me direktivat e transpozuar nga Shqipëria në fushën e mjedisit	08/04/2022	Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit, nr. 94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është ministria përgjegjëse për Kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, një ndër kapitujt me impenjativë, ndërsektorialë dhe të kushtueshëm të acquis (legjislacionit të BE-së). MTM drejton këtë kapitull me bashkëangazhimin e një numri prej 29 institucioneve – ministri linje, agjenci dhe institucione varësie.	Përfunduar	0

			<p>Në këtë kuadër, për procesin e integritimit, një proces dinamik dhe në zhvillim të vazhdueshëm, janë hartuar një sërë dokumente pune lidhur me transpozimin, implementimin, kapacitetet dhe nevojat për kuadrin ligjor për secilin nënkaptull.</p> <p>Mesatarisht, Legjislacioni Horizontal është në një nivel të avancuar transpozimi ¹(83,8 %) me 5 direktiva të BE të transpozuara plotësisht, vetëm 1 direktivë në fazën fillestare (më pak se 20% e transpozuar) dhe direktivat e tjera me nivele të ndryshme të statusit të transpozimit.</p> <p>Megjithëse nuk ka një formulë për të dhënë një shifër të saktë për implementimin (si ajo për transpozimin), në një vlerësim të përgjithshëm, Legjislacioni Horizontal është në nivel të mesëm zbatimi, ku katër direktiva janë duke u zbatuar në nivel të avancuar, një rekomandim dhe një direktivë janë zbatuar pjesërisht dhe zbatimi i dy direktivave ende nuk ka filluar. Për dy nga direktivat janë zhvilluar po ashtu plane zbatimi.</p> <p>Legjislacioni i BE-së në këtë sektor mbulon 7 Direktiva dhe 1 Rekomandim:</p> <p>Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)</p> <p>Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)</p> <p>Direktiva e Të Drejtës për të Marrë Informacion – Transpozim 100%</p> <p>Direktiva e Pjesëmarrjes Publike – Transpozim 100%</p> <p>Për të dy direktivat transpozimi është në masën 100% në legjislacionin vendas. Në lidhje me masat e marra për implementimin e tyre, rekomandimet e Bashkimit Europian janë përqëndruar vetëm në direktiven e dytë ku është kërkuar angazhimi i autoriteteve lokale në përfshirjen e publikut në vendimmarrjet lokale. Në nivel qendror</p>		
--	--	--	--	--	--

¹ Vlerësimi i përqindjeve të dhëna në pyetje i referohen dokumentit më të fundit të punuar nga ana e MTM-së me asistencën e Programit të financuar nga qeveria suedeze, “Mbështetje e negociatave shqiptare për mjedisin “SANE 27 – II””

			<p>nuk ka pasur asnjë rekomandim, pra situata funksionon normalisht në lidhje me këto dy direktiva.</p> <p>Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore</p> <p>Rekomandimi 2001/331/EC që parashikon kriteret minimale për inspektimet mjedisore (RMCEI)</p> <p>Direktiva e Infrastrukturës për Informacionin Hapësinor (INSPIRE)</p> <p>Direktiva e Krimit Mjedisor - Ligji nr. 44/2019, datë 18.07.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.11.1995 “Kodi Penal i Shqipërisë” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 131, datë 24.09.2019. Kreu i katërt i ndryshuar i Kodit Penal ka transpozuar plotësisht Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 19 nëntor 2008 për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal.</p> <p>Të 7 direktivat dhe 1 rekomandim, pjesë e nënkapitullit Legjislacioni Horizontal kanë autoritete të qarta kompetente në organikën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencive të saj të varësisë në nivel qendror dhe lokal.</p> <p>Duhet kuptuar se transpozimi dhe përafrimi i legjislacionit të BE-së është një proces i vazhdueshëm, i cili kërkon kohë dhe angazhimin e burimeve të mëdha financiare dhe administrative, i cili jo vetëm për Shqipërinë, por për çdo vend kandidat për në BE paraqet sfidë në vetvete.</p> <p>MTM dhe institucionet e bashkëangazhuara për kapitullin 27, të cilat ushtrojnë kompetenca në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, planifikojnë transpozimin e acquis dhe plane respektive implementuese të tij, në zbatim të prioritetit madhor qeveritar, atë të integritit të Shqipërisë në BE. Në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, një dokument afatmesëm (3 vjeçar), planifikohen për një periudhë 3-vjeçare aktet e parashikuara për transpozim.</p>	
--	--	--	--	--

			<p>Aktet ligjore të nënkapitullit të Menaxhimit të Mbetjeve janë transpozuar pjesërisht (54.8%). Një direktivë është transpozuar plotësisht, ndërsa për 2 direktiva dhe 1 rregullore transpozimi nuk ka filluar ende. Direktivat e tjera janë në nivele të ndryshme, të transpozuar pjesërisht.</p> <p>Duhet kuptuar se ka një ndërlidhje ndërmjet transpozimit të legjislacionit dhe implementimit të tij, pasi ato duhet të jenë në paralel. Nëse transpozohet një direktivë (qoftë pjesërisht apo plotësisht) duhen parashikuar mekanizmat dhe masat për ta bërë të zbatueshëm aktin në fjalë, pasi në rast të kundërt vetë transpozimi e humb kuptimin. Nënkapitulli i mbetjeve (së bashku me atë të cilësisë së ujërave) është ndër nënkapitujt më impenjativë dhe të kushtueshëm. Transpozimi dhe veçanërisht implementimi i tij, paraqesin sfida të vërteta për vendin, pasi kërkon angazhimin e një sërë kapacitetesh në nivel qendror dhe lokal, por mbi të gjitha shuma të mëdha financiare, kostot e të cilave përlllogariten në disa qindra miliona Euro investime.</p> <p>Ndarja e kompetencave për këtë nënkapitull është komplekse, pasi përfshin disa ministri linje, agjenci dhe institucione të varësisë dhe nivelet e qeverisjes lokale (bashkitë dhe drejtori rajonale vendore).</p> <p>Në tabelën e mëposhtme (nën pyetjen 9) është dhënë një kornizë lidhur me ndarjen e kompetencave, përqindjen e transpozimit për secilën direktivë, një kumulative, si dhe fazën e implementimit.</p> <p>Vendi ynë ka katër landfille, si vijon:</p> <p>Landfilli i Bushatit/Shkodër-Lezhë, i Sharrës/Tiranë, i Bajkaj/Sarandë, i Maliqit/Korçë. Vendepozitime ilegale dhe jashtë standardeve mjedisore janë të shumtë, të vendosur në të gjithë Shqipërinë. Disa prej tyre janë rehabilituar për një periudhë tranzitore deri në zgjidhjen e pikës përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, një pjesë tjetër janë mbyllur.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>Aktualisht, nuk ka landfille rajonale për mbetjet inerte. Ka vendepozitime të përkohshme për mbetjet inerte të vendosura në NJQV. Identifikimi i tyre, bëhet nga MIE si institucion përgjegjës për infrastrukturën e mbetjeve.</p> <p>Raportimet kryhen në formë shkresore sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Në mbështetje të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, si dhe VKM-ve në funksion të këtij ligji, të dhënat e raportuara nga bashkitë, prodhuesit, gjeneruesit si dhe transferuesit e mbetjeve nuk janë në një platformë të unifikuar.</p> <p>Më poshtë është një listë e të gjitha direktivave që duhet të transpozohen në Nënkapitullin - Menaxhimi i Mbetjeve, të Kapitullit 27 37- Mjedisi dhe Ndryshimi i Klimës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Direktiva “Për ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve” • Direktiva “Për bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre” • Direktiva “Për automjetet në fund të ciklit të jetës” • Direktiva “Për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike” • Direktiva “Për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse” • Direktiva “Për mbrojtjen e mjedisit nga llumrat e ujërave të zeza” • Direktiva “Për Landfillet” • Direktiva “Për heqjen e PCB/PCT” <p>Sikurse është theksuar më lart, sfida kryesore për implementim mbeten fondet buxhetore të pamjaftueshme.</p>		
2.	24/03/2022	Kërkesë për informacion	08/04/2022		Përfunduar	0

		rreth një reference ligjore në të cilën bazohet orari i zhvillimit të punimeve të përditshme të ndërtimit	(Deleguar AKM-së)			
3.	04/04/2022	Kërkesë për informacion për vënien në dispozicion të VKM-së Nr. 59, datë 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”	12/04/2022	Vënë në dispozicion dokumentet e kërkuara.	Përfunduar	0
4.	06/04/2022	Kërkesë për informacion drejtuar	12/04/2022	Në lidhje me zonën e përmendur informojmë së në vitin 2019 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ndërmorën një studim të gjerë në rang	Përfunduar	0

		<p>Ministres së Turizmit dhe Mjedisit në lidhje me Zonën e Mbrojtur, Lagunën Vjosë-Nartë dhe ndërtimin e Aeroportit të Vlorës</p>	<p>kombëtar për përditësimin dhe saktësimin e kufijve dhe zonimit të brendshëm të rrjetit të Zonave të Mbrojtura në shkallë vendi për të pasqyruar pasaktësitë e vërejtura dhe për të propozuar zona të reja, bazuar në të dhënat dhe studimet e viteve të fundit (të kryera me financim nga projektet e donatorëve të ndryshëm dhe të Komisionit Evropian).</p> <p>Ky proces u ndërmorr dhe u realizua për një sërë arsyesh:</p> <p>Shumë ZM e kishin fituar statusin shumë kohë më parë e kjo bëri që të rishikohen vlerat brenda tyre, pasi kishte mungesë informacioni dhe paqartësi në vlerën e tyre si ZM;</p> <p>Kufijtë natyrorë të ZM-ve nuk ishin të përcaktuara qartë;</p> <p>Kishte një sistem koordinatash të ZM-ve, të papërshtatshëm me sistemin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare - 2010, si sistemi bazë kombëtar;</p> <p>Me miratimin e ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, janë në fuqi kërkesa të një kuadri të ri ligjor, etj.</p> <p>Studimi për rivlerësimin e rrjetit të zonave të mbrojtura mjedisore, që përfundoi në Dhjetor 2019, i është nënshtruar gjithashtu një procesi të konsultimit me grupet e interesit.</p> <p>Në këtë studim, duke marrë parasysh gjendjen e ekosistemit dhe habitateve të florës dhe të faunës së egër, u paraqit dhe propozimi për ndryshim në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë - Nartë, që në propozimin e rrjetit të përditësuar kombëtar të ZM-ve emërtohet Peizazh i Mbrojtur Nartë-Pishë Poro, shoqëruar me hartën GIS për kufijtë e jashtëm.</p> <p>Pas këtij procesi, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 81/2017, datë 4.5.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, Këshilli Kombëtar i Territorit miratoi me një vendim të tij, si institucioni më i lartë në vend i</p>		
--	--	---	--	--	--

			<p>planifikimit hapësinor, hartën e re të zonave të mbrojtura mjedisore në Shqipëri.</p> <p>Nga pika 1 më lart del se procesi për shqyrtimin e ZM ka përfunduar më 2019, dëshmuës që studimi dhe procesi rivlerësimit të ZM është kryer herët në kohë.</p> <p>Për të zbutur apo minimizuar impaktin në zonë të investimit të parashikuar, ne Deklaratën Mjedisore dhe në Raportin e Thelluar të Vlerësimit në Mjedis, janë parashikuar një numër masash (renditur në përgjigjen për pikën 5).</p> <p>Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2014/52/KE) është transpozuar pothuajse plotësisht me Ligjin “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, nr. 10440/2011. Ndryshimet e Direktivës 2011/92/BE të bëra nga Direktiva 2014/52/BE janë transpozuar në legjislacionin kombëtar në vitin 2020, me ndryshimet e Ligjit “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, nr. 10440/2011. Ligji “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” dhe aktet nënligjore të tij rregullojnë procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektet publike dhe private.</p> <p>Referuar përcaktimeve në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:</p> <p>a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;</p> <p>b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Kreun III, të këtij ligji;</p> <p>c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;</p> <p>ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;</p> <p>d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”.</p> <p>Gjithashtu, referuar të njëjtit ligj, përcaktohet:</p> <p>1. Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit për një projekt publik ose privat të përcaktuar në këtë ligj, përpara vendimit për dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit, sigurohet që projekti, i cili mund të ketë efekte domethënëse në mjedis, për shkak, ndër të tjera, të natyrës, madhësisë ose vendndodhjes së tij, t’u jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me Deklaratë Mjedisore ose vendim për VNM-në paraprake.</p> <p>2. Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit, kur shqyrton dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit për një projekt ose vendosjen e kushteve për zhvilluesin, merr në konsideratë deklaratën mjedisore ose vendimin për VNM-në paraprake për ndikimet në mjedis të projektit të propozuar.</p> <p>3. Në rast se autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të projektit merr vendim për miratimin e zhvillimit të projektit në kundërshtim me vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore, jep argumentet përkatëse për këtë vendim.</p> <p>4. Akti për miratimin e zhvillimit duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:</p>	
--	--	--	--	--

			<p>a) arsyetimin nga autoriteti kompetent për efektet domethënëse të projektit në mjedis, duke marrë parasysh rezultatet e shqyrtimit;</p> <p>b) çdo kusht mjedisor të përcaktuar në deklaratën mjedisore ose në vendimin për VNM-në paraprake, përshkrim të karakteristikave të projektit dhe/ose masat e parashikuara për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar dhe, nëse është e mundur, kompensuar ndikimet e rëndësishme në mjedis, si dhe masat e monitorimit.</p> <p>Referuar sa më sipër, është detyrim i zhvilluesve të projekteve të propozuara që të aplikojnë për procesin e VNM-së nëpërmjet hartimit të raporteve të studimeve përkatëse, sikurse dhe duke realizuar proceset e tjera të nevojshme.</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me institucionet e saj të varësisë është autoriteti kompetent e përcaktuar si përgjegjëse për vlerësimin e procesit të VNM-së, referuar detyrimeve të përcaktuara në ligjin 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar.</p> <p>Ndërkohë, është detyrim i autoritetit përgjegjës për miratimin e projektit të propozuar që të sigurohet që projekti, i cili mund të ketë efekte domethënëse në mjedis, për shkak, ndër të tjera, të natyrës, madhësisë ose vendndodhjes së tij, t’u jetë nënshtruar kërkesave të ligjit 10440/2011 dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me deklaratë mjedisore për VNM të Thelluar, ose vendim për VNM-në paraprake.</p> <p>Me qëllim përmirësimit të cilësisë së raporteve të VNM-së, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, është duke përgatitur projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor”.</p> <p>Si në pikën 3 më lart, në Deklaratën Mjedisore dhe në Raportin e Thelluar të Vlerësimit në Mjedis, janë parashikuar një numër masash</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>për të zbutur dhe minimizuar efektet, veçanërisht tek shpendët, nga investimi i parashikuar në zonë, si:</p> <p>Gjatë ndërtimit të aeroportit:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Të shmangen punimet që janë në një gjatësi jo më pak se 600 m nga Kriporja në periudhën nga mesi i muajit maj deri në korrik, për të mos shqetësuar shpendët gjatë periudhës së shumimit të tyre në këto zona. •Referuar Masave zbutëse dhe menaxhuese – peizazhi dhe komoditeti vizual tek Raporti Thelluar i VNM-së, firma ndërtuese në bashkëpunim me ekspertët e fushës të percaktojë specifikisht ngjyrat që nuk ndikojnë në peizazhin dhe impaktojnë sa më pak mjedisin, veçanërisht për avifaunën, dhe kjo të jetë e detyrueshme gjatë gjithë periudhës së funksionimit të aeroportit. •Zona e gjurmës së aeroportit është zonë e rëndësishme për folezimin e shpendëve të tokës, ndaj të realizohet një “Pre Construction Survey” dhe të merren masa për de-privimin e shpendëve për realizimin e folezimit, në periudhën Mars-Prill. <p>Gjatë funksionimit të aeroportit:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Kompania të hartojë dhe zbatojë Planin e Menaxhimit Ekologjik për gjatë gjithë periudhës së funksionimit të aeroportit, një Plan i rishikueshëm në afat 5 vjeçar, në bashkëpunim me stafin e zonës së mbrojtur dhe të sigurojë menaxhimin dhe qëndrueshmerinë për specie më të rrezikuara që ndodhen në zonë, si edhe specie të tjera të përcaktuara në planin e menaxhimit ekologjik. Kompania duhet të angazhohet në menaxhimin dhe financimin e aksioneve të konservimit të tyre, si dhe cdo element tjetër i përcaktuar në raportin e VNM-së. •Në Planin e Menaxhimit Ekologjik (PME) të përfshijë detyrimisht komponente të monitorimit shkencor. Planet e menaxhimit të 		
--	--	--	---	--	--

			<p>specieve të kërcënuara të jenë pjesë integrale në planin e menaxhimit ekologjik.</p> <ul style="list-style-type: none"> •PME duhet hartuar para vendosjes në funksionim të aeroportit dhe pjesa kyçe duhet të jenë objektivat e rehabilitimit/kompesimit të financuara nga subjekti, suporti për programe edukimi, restaurim habitatesh dhe rigjenerimin të popullatave të kafshëve të egra. •Kompania të ketë parasysh shmangien e fluturimeve ose devijimin e trajektoreve së uljes dhe ngritjes së avionëve gjatë periudhave të migrimit të shpendëve, veçanërisht në periudhën e shtegimit të shpendëve që i përkon me periudhën e muajit Marsit kryesisht (shtegtimi i pranverës) dhe nga Gushti në Tetor (shtegtimi i vjeshtës). Përcaktimi i saktë i koridorëve dhe publikimi i linjave të fluturimit do të ndihmonte në këtë drejtim, për të lejuar specialistët e lëvizjes së avionëve gjatë periudhave të migrimit të verifikojnë respektimin e masave të përcaktuara. Ky planifikim të përfshihet edhe në PME. •Aeroporti të përcaktojë një individ ose strukturë të veçantë përgjegjës për të monitoruar dhe raportuar mbi komponentet mjedisore, që do të mbajë kontaktet me AKM/AKZM-në. •Të zgjidhet një konsulent i jashtëm mjedisor për biodiversitetin, që duhet të jetë një subjekt i pavarur, me njohuri të thelluara në aspektet mjedisore të përcaktuara në VNM. Në Komitetin e Menaxhimit të zonave të mbrojtura në qarkun Vlorë, do të përfshihen administratori i aeroportit dhe konsulenti mjedisor, të cilët do të kenë detyrim të raportojnë mbi realizimin e PME. •Me qëllim zbutjen e ndikimit, të shmanget plotësisht shfrytëzimi i tokave bujqësore përreth gjurmës së aeroportit. Kompania mund të blejë ose të marrë në përdorim tokat bujqësore që rrethojnë aeroportin dhe të sigurohet që të mos realizohen ndërhyrje, si masë zbutëse kjo për kompesimin e dëmtimit të habitateve. 		
--	--	--	--	--	--

				Vendimi i Këshillit të Ministrave miraton studimin e përmendur më sipër të nisur në vitin 2019, të kryer nga specialistët e MTM – së dhe AKZM – së. Nuk rezulton të ketë një premtim të ndryshëm nga ky studim.		
5.	06/04/2022	Kërkesë për informacion nga Birn Albania dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit në lidhje me disa investime strategjike që prekin zona të mbojtura.	15/04/2022 Deleguar AKZM-së	Vënë në dispozicion dokumentacioni sipas kërkesës.	Përfunduar	0
6.	06/04/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me mbështetjen financiare të Projekteve në Turizëm.	28/04/2022	Ne vijim te kerkeses suaj per informacion, drejtuar Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit, lutem gjeni pergjigjen sipas linkut https://turizmi.gov.al/thirrje-per-mbeshtetje-financiare-te-projekteve-ne-turizem/ , nepermjet te cilit do te informoheni ne lidhje me projektet qe jane perzgjedhur te perfitojne mbeshtetje financiare nga buxheti i shtetit.	Përfunduar	0
7.	07/04/2022	Kërkesë për informacion në lidhje më kategorizimin e subjektit hotelier	26/04/2022	Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion drejtuar Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit, ju informoj se subjekti “Amare Hotel shpk” eshte kategorizuar ne kategorine HOTEL ne daten 11.03.2022. Certifikata eshte nisur me poste.	Përfunduar	0

		“Amare Hotel sh.p.k”				
8.	15/04/2022	Kërkesë për praktikë pune në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.	28/04/2022	<p>Ju informojme se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka administruar dhe shqyrtuar kërkesen tuaj për zhvillimin e praktikës së punës pranë institucionit tënde.</p> <p>Ne mirepresim angazhimin e studentëve të cilët duan të aftësohen dhe të rriten profesionalisht nëpërmjet kryerjes së praktikave të punësimit në organet e administratës publike, prandaj në mënyrë që ne të procedojmë me kërkesen tuaj, lutemi që të sillni një kërkesë fizike për internship pranë ambjenteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe me vone do të njoftoheni për ofrimin e një mundësie të tillë.</p>	Përfunduar	0
9.	19/04/2022	Kërkesë për informacion lidhur me raportimet mbi çështjet e administrimit të burimeve natyrore të vendit, krizën mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	27/04/2022	Vënë në dispozicion dokumentat zyrtare, me të gjithë informacionin e nevojshëm.	Përfunduar	0
10.	20/04/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me vendimin e qeverisë për të	28/04/2022	Referuar VKM-se Nr.584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, lutemi që ky informacion të kërkohej pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, si institucioni përgjegjës i cili është hartues dhe iniciues i projektaktit dhe percjell	Përfunduar	0

		marrë anije me qira të cilat do të prodhojnë energji elektrike dhe do të vendosen në Triportin e Vlorës		dhe ndjek procedurat e konsultimeve si dhe procedurat e tjera ligjore.		
11.	22/04/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me kontraktimin e operatorit për menaxhimin e situatës së mbetjeve në bregdet, gjatë sezonit turistik.	05/05/2022	<p>Operatori ekonomik do të kontraktohet (pasi nuk është pëzgjedhur ende) sipas përcaktimeve të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.</p> <p>Sipas parashikimeve ligjore, Agjencia Kombëtare e Bregdetit do të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, që do të kryhet në mbështetje dhe plotësim të shërbimit të ofruar nga organet kompetente të qeverisjes qendrore apo të njëjve të qeverisjes vendore dhe nuk prek kompetencat e tyre të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Për vitin 2022, ky shërbim i pastrimit të zonës bregdetare nga AKB-ja sigurohet vetëm për Bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë dhe Sarandë, për periudhën 15 qershor deri më 15 shtator 2022.</p> <p>Autoriteti Kontraktor ka analizuar dhe përlogaritur vlerën e këtij shërbimi bazuar në sistemin standard të llogaritjes së kostos së shërbimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane për Njësitë Qeverisjes Vendore/ Autoriteteve Kontraktore, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.10463 22.09.2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (të ndryshuar), VKM nr.319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për Koston e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, sipas dokumenteve “Udhëzues për llogaritjen e</p>	Përfunduar	0

				<p>kostove për menaxhimin e mbetjeve” dhe “Modelet për llogaritjen e tarifave për menaxhimin e mbetjeve”, përkatësisht, shtojcat 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.</p> <p>Buxheti i parashikuar për këtë shërbim është në vlerë 91.557.753 lekë pa TVSH.</p>		
12.	24/04/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me disa pyetje sa i përket shfrytëzimit të pyjeve.	28/04/2022	<p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare.</p> <p>Përgjegjësitet e saj përcaktohen në pikën 2 të nenit 15 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 17.07.2019, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.</p> <p>Referuar pikave 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 684, datë 2.09.2020:</p> <p>1. Sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas listave të inventarit, infrastruktura mbështetëse e tyre, asetet, arkivi dhe protokoli, aktualisht, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mjedisit, si edhe sipërfaqet e fondit pyjor e kullor publik dhe infrastruktura mbështetëse e tyre, që i janë transferuar ish- komunave e bashkive, transferohen në pronësi të bashkive.</p> <p>2. Të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë/juridikë të fituara me kontratat ekzistuese për marrjen në përdorim të sipërfaqeve të fondit</p>	Përfunduar	0

			<p>pyjor dhe kullisor vazhdojnë deri në përfundimin e tyre, sipas parashikimeve kontraktore dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>Për sa më lart, Bashkitë me tagrin e pronarit të fondit pyjor që kanë në juridiksionin e tyre territorial lidhin kontrata për shfrytëzimin e fondit pyjor.</p> <p>Referuar nenit 2, pikave (a) dhe (c) të pikës 1 të nenit 3 dhe nenit 5 të ligjit Nr. 5/2016, datë 4.2.2026, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”:</p> <p>“Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor publik/privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, tregtimi i produkteve të tij, ndalimi i eksportit të lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, drurëve të zjarrit”.</p> <p>Përjashtohen nga fusha e zbatimit të nenit 2 të këtij ligji:</p> <p>Shfrytëzimi i lëndës drusore për plotësimin e nevojave të banorëve të bashkive për dru zjarri;</p> <p>Shfrytëzimi i lëndës drusore për rigjenerimin, shëndetësimin e pyjeve dhe pastrimin e mbetjeve drusore.</p> <p>Kritereve dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, me qëllim plotësimin e nevojave të popullatës me dru zjarri dhe shëndetësimin e pyjeve, pa cenuar rregullat e vendosura nga ligji nr. 5/2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë” janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 438, datë 8.6.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”.</p> <p>Afati i zbatimit të ligjit nr. 5/2016 është 10 (dhjetë) vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi.</p>	
--	--	--	---	--

13.	27/04/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurat e regjistrimit të Hotelit.	09/05/2022	Sa i perket procedurave se regjistrimit te hotelit dhe procedurave regjistruese si strukture akomoduese prane ministrise, ju bejme me dije se informacionin e duhur per proceduren qe do te ndiqet, e gjeni sipas linkut bashkelidhur: https://turizmi.gov.al/kategorizimi-i-strukturave-turizmi/	Përfunduar	0
14.	29/04/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me lejet mjedisore të dhëna për ndërtimin e disa HEC-eve.	19/05/2022	Deleguar dhe kthyer përgjigje nga AKZM.	Përfunduar	0

MAJ 2022

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigje	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
15.	06/05/2022	Kërkesë për informacion sa i përket disa pyetjeve	17/05/2022	Mbështetur në vendimarrjet e Qeverisë Shqiptare, janë parashikuar të ndërtohen në vendin tonë 3 impiante incenerimi kryesisht për bashkitë e qarqeve: a. Qarku Elbasan; b. Qarku Fier dhe c. Qarku Tiranë.	Përfunduar	0

		mbi inceneratorët dhe Bashkitë përkatëse që i mbulojnë.		<p>-Në zbatim të Urdhrit nr. 223, datë 23.11.2017 “Për marrjen në dorëzim të dokumentacionit në lidhje me procedurat për “Ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan për prodhimin e energjisë”, “Dhënies me konçension e ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve të Qarkut Fier dhe prodhim energjie” si dhe “Dhënien me konçension për ndërtimin e landfillit inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë”, i gjithë dokumentacioni, ndjekja e punimeve dhe detyrimet financiare që rrjedhin nga kontratat, janë në proces ndjekje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.</p> <p>-Nga informacioni shkresor i dërguar nga institucionet, për impiantin e zonës së qarkut Elbasan i cili pavarësisht se është sekuestruar nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për administrimin e shoqërisë “Albtek Energy”, po vijon funksionimi;</p> <p>-Për impiantin e qarkut Fier, ju njoftojmë se nga korrespondenca zyrtare me MIE, afati i përfundimit të kontratës për ndërtimin, është në datë 24.10.2022.</p> <p>-Ndërsa sa i përket impiantit të qarkut Tiranë, është në ndjekje nga MIE.</p> <p>Për pikën 3, dhe në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, dhe aktet e tjera ligjore në fuqi, trajtimi i mbetjeve bëhet në nivel rajonal dhe si i tillë, bashkitë të cilat kanë një impiant dhe venddepozitim sanitar, janë të detyruara të depozitojnë mbetjet në vendet e përcaktuara nga institucionet përkatëse.</p> <p>Mbështetur në detyrimet ligjore në fuqi, konkretisht të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe akteve nenligjore që rrjedhin nga ligji i sipërcituar, të gjitha bashkitë janë të detyruara të realizojnë detyrimet ligjore për parandalimin, ripërdorimin, riciklimin, incenerimin dhe asgjësimin e kontrolluar sanitar.</p>		
16.	06/05/2022	Kërkesë për informacion nga Top Channel në lidhje me	16/05/2022	<p>Vendi ynë ka aktualisht një sipërfaqe pyjore prej 1 051 832 Ha (hektarë) dhe një volum prej 54 845 573 m³ (metër kub).</p> <p>Kategorizimi i pyjeve mbështetet në klasifikime teknike të ndryshme, por në vendin tonë dy janë kategorizimet kryesore që përdoren për pasqyrimin e të dhënave:</p>	Përfunduar	

		<p>sipërfaqet pyjore në vendin tonë.</p>	<p>a.kategorizimi mbi origjinën e pyllit, i cili i diferencon ato në Trungishte, Cungishte dhe Shkurre.</p> <p>b.kategorizimi i fondit pyjor sipas kompozimit të llojeve.</p> <p>Sipas të dhënave kadastrale në vitin 1990, sipërfaqja pyjore ka qenë 1 044 680 Ha dhe volumi i përgjithshëm 82 138 000 m³.</p> <p>Krahasuar me vitin aktual, sipërfaqja e fondit pyjor rezulton me një shtesë prej 7 152 ha dhe me një diferencë në volum prej 27 292 427 m³. Zonat që kanë pësuar humbje më të mëdha konsiderohen ato të Shqipërisë Veriore Qëndrore dhe shkaktar kryesor konsiderohet ZJARRI.</p> <p>Në 5 vitet e fundit janë mbjellë 8 325 935 me një mesatare vjetore prej 1 665 000 fidanë.</p> <p>Sipërfaqja e pyjeve e djegur gjatë vitit 2017, llogaritet në rreth 3222 ha, me 105 numër rastesh në total vendi.</p> <p>Sipërfaqja e pyjeve e djegur gjatë vitit 2018, llogaritet në rreth 552 ha, me 48 numër rastesh në total vendi.</p> <p>Sipërfaqja e pyjeve e djegur gjatë vitit 2021, llogaritet në rreth 1482 ha, me 55 numër rastesh në total vendi.</p> <p>Për vitet 2019 dhe 2020 nuk kemi të dhëna.</p> <p>Numri total i punonjësve pranë strukturës së pyjeve në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore është 634 punonjës.</p> <p>Ashtu sikurse jeni në dijeni, Qeveria Shqipëtare me propozim të Ministrisë së Mjedisit, miratoi në parlament ligjin nr. 5/2016, datë 04.02.2016 “Për shpalljen e moratoriumit mbi pyjet në Republikën e Shqipërisë”. Aktualisht jemi në vitin e 7 të tij dhe efektet e tij llogariten të jenë të konsiderueshme sa i përket kjo konserimit të lëndës drusore (lënda e punimit) për qëllime tregëtare. Efektet e moratoriumit mbi pyjet</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>të vendosur 7 vite më parë, kanë dhënë rezultate pozitive dhe të dhënat flasin për një përmirësim të jashtëzakonshëm të situatës. Në këtë këndvështrim, nëse karahasojmë të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, “Për importin e lëndës drusore për përdorim të brendshëm”, vetëm gjatë 1 viti eksportet janë rritur me rreth 30% ose 78 750 m3(metër kub). E përkthyer kjo në shifra të konservimit të fondit pyjor kombëtar, do të thotë që kemi kursyer 700 ha me pyje në moshën e shfrytëzueshmërisë (81-100 vjeç), gjatë periudhës 2016-2022.</p> <p>Po në këtë logjikë, moratoriumi ka qenë akoma më efikas nëse në llogaritjet tona përdorim krahasimet ndërmjet sasisë së lëndës drusore të shfrytëzuar para hyrjes në fuqi të moratoriumit, dhe asaj që është shfrytëzuar pas hyrjes në fuqi të moratoriumit. Nga llogaritja e të dhënave rezultojnë që mesatarisht në 1 vit të jenë konservuar rreth 250 mijë m3 lëndë drusore, dhe për 7 vjet të jenë konservuar rreth 1.7 milion m3. Nëse kjo shifër konvertohet në sipërfaqe pyjore të konservuar, do të thotë që në një vit kemi konservuar një sipërfaqe prej 546 Ha me pyje në moshën e shfrytëzueshmërisë (81-100 vjeç), dhe për 7 vjet (2016-2022), të jenë konservuar rreth 4000 ha me pyje.</p> <p>Për më shumë akoma, efektet e moratoriumit mbi pyjet kanë qenë shumë pozitive nëse i referohemi ndërhyrjeve të paligjshme mbi fondin pyjor. Krahasuar me vitin 2013, aktualisht aktivitetet ilegale dhe kundravajtjet pa përgjegjësi mbi fondin pyjor janë ulur 170%, dhe me tendencë për zhdukjen graduale të fenomenit.</p> <p>Zonat të cilat konsiderohen “hot spote” në pyje, janë zona të cilat janë dëmtuar duke humbur funksionalitetin e tyre “pa kthim” dhe/ose ku rigjenerimi dhe kthimi në funksionalitet kërkon një kohë shumë të gjatë natyrisht (100-150 vite).</p> <p>Në total, janë 282 spote të tilla në rang kombëtar, të cilat formojnë një sipërfaqe prej 8514 Ha (hektarë), të gjitha të evidentuara dhe me projekte të gatshme rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimeve artificiale.</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) ka të evidentuar dhe të mbuluar me projekte të gjitha zonat e degraduara pyjore ne rang vendi. Megjithë kostot e mëdha financiare që kërkojnë këta sipërfaqe për t'u kthyer në normalitet, MTM ka mbështetur dhe po mbështet pushtetin vendor dhe pronarët e pyjeve si nëpërmjet hartimit të politikave të reja ashtu dhe me mbështetje financiare. Një lajm i mirë në këtë drejtim, është së vendi ynë sapo ka përfituar një grant prej rreth 8 milionë euro nga Bashkimi European, në kuadër të projekteve IPARD III, ku pyjet do të jenë pjesë e kësaj skeme financimi.</p> <p>Të dhënat e Inventarit Kombëtar të fundit të pyjeve janë në proces shqyrtimi dhe miratimi. Sapo të kemi një miratim përfundimtar të tyre do të mund t`ju vihen në dispozicion.</p> <p>E drejta për të prerë dru zjarri (për të shfrytëzuar) fondin pyjor i takon çdo lloj kompanie që përmbush kriteret dhe kushtet teknike të paracaktuara në aktet ligjore në fuqi. Lista e kompanive sipas kontekstit të kësaj pyetje, mund të kërkohet nga QKL.</p> <p>Theksojmë se nuk ka asnjë kontratë koncensionare me objekt "Për prerje dru zjarri" me asnjë kompani në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Nuk ka asnjë metër katror sipërfaqe pyjore të dhënë me koncension.</p>		
17.	10/05/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me disa të dhëna për punonjësit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit	12/05/2022	<p>Numri i punonjësve sipas strukturës - 132</p> <p>Numri i punonjësve fakt - 124</p> <p>Vjetërsia në punë</p> <p>0 vite vjetërsi pune - 10 punonjës</p> <p>1-5 vite vjetërsi pune - 25 punonjës</p> <p>5-10 vite vjetërsi pune - 26 punonjës</p> <p>10-20 vite vjetërsi pune - 37 punonjës</p>	Përfunduar	0

				<p>20-30 vite vjetërsi pune - 12 punonjës</p> <p>mbi 30 vite vjetërsi pune - 4 punonjës</p> <p>Nisur nga pandemia COVID-19, nevojat për trajnim për vitin 2021 janë vlerësuar dhe mbledhur individualisht për punonjësit nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA). Duke qenë se, këto trajnime janë ndjekur on-line dhe një pjesë e tyre nuk kanë përfunduar me certifikim, nuk disponojmë informacion në lidhje me këto trajnime.</p> <p>Meqenëse trajnimet e stafit të MTM-së janë organizuar dhe zhvilluar nga ASPA dhe një pjesë e të cilave on-line, MTM nuk ka shpenzuar fond vitin e kaluar dhe nuk ka planifikuar një fond për trajnimet e stafit për vitin 2022.</p> <p>Aktualisht, MTM është duke analizuar dhe vlerësuar nevojën e një ristrukturimi të institucionit i cili rrjedhimisht do të evidentojë nëse do të këtë nevojë për shtim kapacitetesh të stafit të saj.</p> <p>Lirim nga detyra - 1 punonjës</p> <p>Lirim nga detyra me dorëheqje - 9 punonjës</p> <p>Pezullim nga detyra - 3 punonjës</p> <p>Levizje paralele - 2 punonjës</p> <p>Ngritje në detyrë - 1 punonjës</p> <p>Përfundim mandati -1 punonjës</p>		
18.	10/05/2022	Kërkesë për informacion me pyetje shitesë nga Top Chanel në lidhje me kontratat koncensionare	16/05/2022	Përgjigjet sipas pikës 2 te Regjistrit për Muajin Maj.	Përfunduar	0

		për shfrytëzimin e pyjeve.				
19.	12/05/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me moratoriumin dhe kafshët e egra në vendin tonë, si dhe situatën në pyje.		E patrajtuar.	Në Proces	0
20.	12/05/2022	Kërkesë për informacion, sa i përket disa pyetjeve për menaxhimin e industrisë së turizmit gjatë pandemisë së COVID19.	26/05/2022	<p>Në vitin 2020, Shqipëria u vizitua nga 2,700,000 vizitorë duke shënuar një rënie prej 58% krahasuar me vitin 2019 dhe humbjen prej më shumë se 1.5 miliardë euro.</p> <p>Qeveria shqiptare mori një sërë masash duke e mire-menaxhuar situatën dhe duke u klasifikuar si një vend dhe destinacion i sigurtë.</p> <p>Duke ju referuar praktikave më të mira të sugjeruara nga Organizata Botërore e Shëndetit dhe sugjerimet e UNËTO, u miratua “Protokolli i Masave Anti COVID-19”.</p> <p>Qeveria krijoi një Komitet Ad Hoc, Menaxhues të Sezonit Turistik të kryesuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe me anëtarë përfaqësues të nivelit të lartë nga:</p> <p>a) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;</p> <p>b) Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës;</p> <p>c) Ministria e Mbrojtjes;</p>	Përfunduar	0

			<p>d) Ministria e Brendshme;</p> <p>e) Ministria e Kulturës;</p> <p>f) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.</p> <p>Ky Komitet monitoroi ecurinë e sezonit turistik 2020, si dhe mundësoi koordinimin ndërinstitucional për respektimin e masave për të përballuar pasojat e shkaktuara nga Covid19.</p> <p>Bazuar në Protokollin për menaxhimin e sezonit turistik, u arrit të krijohen stacione plazhi, me standarde të mirëpërcaktuara për mbrojtjen maksimale të pushuesve dhe turistëve.</p> <p>Që nga fillimi i Marsit 2020, të gjitha aktivitetet me risk të lartë të përhapjes së infeksionit u mbyllën. Kjo u shoqërua me masa financiare mbështetëse.</p> <p>1. Për të lehtësuar biznesin e turizmit nga barra fiskale, qeveria shqiptare mori masa të ndryshme, si:</p> <p>a) Të gjitha bizneset e vogla turistike (transport turistik, agjenci udhëtimesh, operator turistik, akomodim, bar dhe restorante, stacion plazhi, shërbime të tjera të lidhura me turizmin etj) me një xhiro vjetore deri në 110,000 EURO (që përfaqësojnë 70% të segmentit të akomodimit) të përjashtohen nga tatimi mbi fitimin për vitin 2020;</p> <p>b) Bizneset e tjera turistike (transport turistik, agjenci udhëtimesh, operator turistik, akomodim, bar dhe restorante, stacion plazhi, shërbime të tjera të lidhura me turizmin etj) me një xhiro vjetore mbi 110,000 EURO (që përfaqëson 30% të segmentit akomodues) e shtyjnë pagesën e tatimit mbi fitimin faktik për vitin e ardhshëm.</p> <p>c) Pushtetet vendore kanë shtyrë pagesat e taksave dhe tarifave vendore për të gjitha bizneset turistike.</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>2. Për të siguruar një nivel të rehatshëm të ardhurash, Qeveria e Shqipërisë aplikoi skema të ndryshme:</p> <p>a) Një ndihmë financiare prej 25 000 lekë/muaj iu dha punonjësve në bizneset e vogla turistike (transport turistik, agjenci udhëtimesh, operator turistik, akomodim, bar dhe restorante, stacion plazhi, shërbime të tjera të lidhura me turizmin etj.) me një qarkullim vjetor deri në 110,000 EURO për një periudhë tre mujore pas pezullimit të aktivitetit të tyre ekonomik/marrëdhënies të punës për shkak të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, sipas urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;</p> <p>b) Një pagesë e vetme prej 40 000 lekësh është dhënë si ndihmë financiare për punonjësit në biznese të tjera turistike (transport turistik, agjenci udhëtimesh, operator turistik, akomodim, bar dhe restorante, stacion plazhi, shërbime të tjera të lidhura me turizmin etj.) me një xhiro vjetore mbi 110,000 EURO, të cilat mbyllën aktivitetet e tyre sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët ishin në punë në datën e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave ose ndaj ish-punonjësve në subjektet që u lejuan të kryenin veprimtari.</p> <p>3. Për të mbrojtur vendet e punës dhe për të siguruar likuiditet për bizneset, Qeveria dhe Banka e Shqipërisë zbatuan masa të ndryshme:</p> <p>a) E para, një skemë garancie kredie shtetërore, me vlerë 88 milionë euro, për të mundësuar kreditimin e sipërmarrësve dhe kompanive për të mbuluar pagat e tyre në rastet kur aktiviteti i tyre u mbyll ose u ndikua nga një rënie e xhiros, si rezultat i Vendimeve të Këshillit të Ministrave në kuadër të situatës së krijuar nga COVID-19.</p> <p>b) E dyta, një skemë garancie për kredi shtetërore, me vlerë 120 milionë euro, për të mundësuar kreditimin e sipërmarrësve dhe kompanive, për kapital qarkullues dhe investime në mbështetje të rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik të prekur nga situata e krijuar nga COVID-19.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>c) I treti, një amendament rregullator i miratuar nga Banka e Shqipërisë, i cili u mundëson bankave dhe institucioneve financiare jobanka të shtyjnë me gjashtë muaj (mars-gusht 2020) pagesën e kësteve të kredisë nga klientët, duke mos i tarifuar ato me penalitete ose përkeqësim të statusit të kredimarrësit, për shkak se mospagesa e kredisë vjen si pasojë e situatës së vështirë financiare të krijuar nga pandemia COVID-19.</p> <p>Nga këto paketa financiare përfituan rreth 3641 subjekte në sektorin e turizmit, konkretisht:</p> <p>a) 2694 struktura akomoduese;</p> <p>b) 148 operatorë turistikë;</p> <p>c) 536 agjenci udhëtimi;</p> <p>d) 245 udhërrëfyes turistik;</p> <p>e) 18 Subjekte agroturistike.</p>		
21.	17/05/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me urdhër pagesat që duhet të kryhen për stacionet e plazhit.	18/05/2022	<p>Deleguar AKB-së</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj, për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi për sezonin turistik veror 2022, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar, ju informojmë se:</p> <p>1.Nga verifikimi i aplikimit në sistemin e-Albania, rezulton se ju keni aplikuar si subjekt me NIPT M26407002U, për parcelën SH-75.</p> <p>2.Aplikimi juaj për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, për parcelën SH-75 është miratuar dhe njoftimi për ju është realizuar përsëri nëpërmjet sistemit e-Albania, për të vijuar fazën e negociimit me Bashkinë Shkodër.</p>	Përfunduar	0

				<p>3.Nga momenti i marrjes së miratimit paraprak nga GTSHA, në zbatim të parashikimeve të VKM-së 171/2019, i ndryshuar, ju duhet të vijoni fazën e negociimit me Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore, Bashkia Shkodër, për përgatitjen e planvendosjes për parcelën SH-75 dhe gjenerimin e mandatpagesës për këtë sipërfaqe. Pas realizimit të këtij procesi AKB, do të vijojë për përgatitjen e kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit me subjektin tuaj.</p>		
22.	18/05/2022	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me nismën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për heqjen nga përdorimi të qeseve plastike.</p>	19/05/2022	<p>Ju bëjmë me dije se është miratuar Ligji nr 28/2022 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 463, DATË 22.9.2011, “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, i ndryshuar, i cili ka objekt ndalimin e prodhimit, importimit dhe tregtimit të qeseve plastike mbajtëse njëpërdorimshe, me trashësi nën 70 mikron nga secila anë dhe kapacitet më të vogël se 10 kilogramë.</p> <p>Ligji shoqërohet me akt nënligjor, i cili përcakton kushtet dhe kriteret të posaçme për zbatimin e tij.</p> <p>Ministria ka hartuar planin e masave për monitorimin dhe zbatimin e ligjit të sipërcituar si dhe të aktit nënligjor. Gjithashtu pjesë e planit të masave është edhe ndërgjegjësimi me qytetaret duke i sensibilizuar për efektet negative të përdorimit të qeseve, por edhe tregtuesit dhe prodhuesit e tyre.</p> <p>Ndërgjegjësimi ka filluar me shpërndarjen e fletëpalosjeve informuese dhe me paraqitjen e videove ndërgjegjësuere në faqen zyrtare të Ministrisë.</p> <p>Zbatimi do të shoqërohet me monitorim të përditshëm tek prodhuesit, importuesit dhe tregtuesit. Ky monitorim pritet të japë efektet e dëshiruara në një kohë të shkurtër.</p> <p>Informojmë se kompanitë prodhuese të qeseve kanë qenë pjesë e diskutimeve me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe kanë marrë</p>	Përfunduar	0

				<p>pjesë në diskutimet e komisioneve parlamentare ku është paraqitur projektligji, i cili më pas është miratuar.</p> <p>Ligji dhe akti nënligjor, parashikojnë masat që duhet të marrin kompanitë e prodhimit të qeseve dhe penaltitetet për mosrespektimin e akteve.</p> <p>Ju informojmë që kompanitë dhe shoqatat përfaqësuese kanë qenë pjesë e diskutimit që në hapat e parë të draft-ligjit si dhe kanë marrë pjesë edhe në diskutimet me komisionet parlamentare ku është shqyrtuar ky akt.</p> <p>Në aktin nënligjor që rrjedh nga ligji i sipërcituar, janë vendosur masat për monitorim si dhe penaltitetet që do të kenë prodhuesit, shitësit dhe përdoruesit e qeseve, të cilët nuk janë në respektim me kriteret e vendosura në aktin ligjor.</p>		
23.	18/05/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me lejet e mjedisit për zhurmat.	26/05/2022	<p>Deleguar AKM-së</p> <p>Aktivitete të tilla në Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar kanë qenë objekt i lejes së thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis dhe kjo leje është klasifikuar si leje mjedisore e tipit C me specifikim për zhurmat .</p> <p>Gjatë vitit 2020, Ligji Nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, u ndryshua me Ligjin Nr. 52/2020, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, Për Lejet e Mjedisit”, dhe specifikisht, lejet e mjedisit të tipit C u hoqën nga fusha e veprimtarisë së këtij Ligji dhe rrjedhimisht Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk lëshon më leje mjedisi të tipit C.</p> <p>Në zbatim të VKM-së, Nr. 568, datë 17.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit kryen inspektime në bazë të një programi tematik mbi bazë risku të miratuar nga Ministri, që realizohet</p>	Përfunduar	0

			<p>mbi bazën e regjistrave të subjekteve që janë të pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B.</p> <p>Në nenin 7 të Ligjit Nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" dhe në pikën 2 të VKM-së Nr. 587, datë 07.07.2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike" përcaktohet se, matjet e nivelit të zhurmave dhe vlerësimi i tyre kryen nga Instituti i Shëndetit Publik.</p> <p>Për sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka ekspert të certifikuar për matjen e nivelit të zhurmave apo vlerësimin e tyre, por nëse na vihet në dispozicion një raport i matjes së zhurmave të cilat janë mbi normën e përcaktuar në aktet ligjore, jemi të gatshëm të marrim masa konform legjislacionit në fuqi.</p> <p>Në bazë të Ligjit Nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës" Neni 8 pika 5 "Të konstatojë, parandalojë e ndëshkojë ndotjet e mjedisit, hedhjen e mbeturinave të ndryshme, si dhe të sinjalizojë kryetarin e bashkisë ose komunës për shfaqjet e parazitëve të dëmshëm e të rrezikshëm, si dhe për rastet e shfaqjes së epidemive", VKM-së Nr. 515, datë 17.07.2019 "Për një shtesë në Vendimin Nr. 502, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme" të ndryshuar, referuar gërmës f, të pikës 3, në fushën e përgjegjësisë është shtuar "Parandalimi, mbrojtja, mbikqyrja dhe kontrolli i legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundraligjshme të cdo lloji", Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" si dhe referuar pikës 1, të nenit 24, të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", referojmë Komisaratin e Policisë të zonës përkatëse, Policinë Bashkiake si dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për marrjen e këtij informacioni sipas legjislacionit në fuqi.</p>		
--	--	--	--	--	--

24.	30/05/2022	Kërkesë për informacion nga Lëvizja MJAFT në lidhje me strategjitë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.	21/06/2022	<p>Strategjia e Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur në faqen e saj Aktivitetet për edukimin ligjor të publikut që ka zhvilluar në kuadër të ligjit të Pyjeve, Strategjisë për menaxhimin e mbetjeve dhe VKM-të në fushën e turizmit për përdorimin e plazheve.</p> <p>VENDIM Nr. 878, datë 11.11.2020 “Për miratimin e planit të Veprimit 2020–2023, në zbatim të strategjisë së Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023”.</p> <p>https://turizmi.gov.al/ep-content/uploads/2021/05/PlaniVeprimitSELP.pdf</p> <p>Shtojcat e kontratave të procedurave të prokurimit publik nuk janë të publikuara në faqen tonë zyrtare.</p> <p>Ministria ka hartuar së fundmi Ligjin nr 28 datë 17.3.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hartuar gjithsej 42 projektakte, si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Projektligj “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” 2.Projektligji “Për gazet serrë të florinuara”; 3.Ligj nr. 11/2021,datë 1.2.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004,“Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar 4.Ligj nr. 39/2021datë 23.3.2021Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr. 1, në lidhje me 	Përfunduar	0
-----	------------	---	------------	---	------------	---

			<p>marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH –Shqipëri, llogari bashkëpunimi”;</p> <p>5.Projektvendimi “Për Strukturën e RKFPsë, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”</p> <p>6.Projektvendimi “Për shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.171, datë 27.03.2019, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores, për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar;</p> <p>7.Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.687, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen , përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"</p> <p>8.PVKM “Për miratimin e listës së substancave kandidate”;</p> <p>9.Projektvendim “Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të bimëve/florës dhe kafshëve/faunës të vendit”;</p> <p>10.Projektvendim “Për miratimin e dokumentacionit shoqërues të formularit, afatet dhe procedura e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me deklarata, si dhe deklarata për arritjen e fazës së zhvillimit përfundimtar të kërkimit shkencor”;</p> <p>11.Projektvendim “Për kriteret dhe procedurat për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë"</p> <p>12.Projektvendimi "Për kriteret e ushtrimit, të miratimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në fondin pyjor kombëtar";</p> <p>13.Projektvendimi "Për masat lidhur me sigurimin e informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO2 gjatë marketingut të automjeteve të reja";</p> <p>14.VKM-në nr. 704, datë 18.11.2021 "Për disa ndryshime në VKM-në nr. 162, datë 02.03.2016 "Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit",</p> <p>15.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 18.11.2021Për disa shtesa në vendimin nr. 162, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit".</p> <p>16.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 3.3.2021Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotavepublike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", të ndryshuar</p> <p>17.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 22.9.2021 Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor.</p> <p>18.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 22.9.2021Për disa shtesa në vendimin nr. 687, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>19.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 309, datë 26.5.2021 Për heqjen nga fondi pyjor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 5.3749 ha, në objektin “Krastë–Thekën”, të Bashkisë Bulqizë, që do të përdoret nga shoqëria “Koxherri”sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të kromit</p> <p>20.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 26.5.2021 Për heqjen nga fondi pyjor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 2.874 ha, në objektin “Rubik”, të Bashkisë Mirditë, që do të përdoret nga shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të Bazaltit.</p> <p>21.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 11.5.2021 Për heqjen nga fondi kullor dhe ndryshimin e statusit nga kategoria e resursit “kullotë” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me numër 28/3, dhe miratimin e ndryshimit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me numër 26, zona kadastrale 2936, Bashkia Tepelenë</p> <p>22.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 20.1.2021 Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij.</p> <p>23.Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 10.2.2021 Për rregullat e përdorimit dhe të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe pagimin e çmimeve për to</p> <p>24.Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 303, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”</p> <p>25.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 27.1.2021 Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të një pjese të pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej 19 000 m2, nga trualli funksional i pronës ndodhur</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>në zonën kadastrale 8340, me numër pasurie 8/76, me sipërfaqe prej 46 266 m², me emërtimin “Stacion hekurudhor”, Tiranë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 714, datë 20.10.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e përgjegjësishë së administrimit, nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të Ministrisë së Drejtësisë, të sipërfaqes 46 266 m², në zonën kadastrale nr. 8340, me numër pasurie 8/76, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 120, datë 4.3.2004, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit’”</p> <p>26.Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 25.3.2021 Për një shtesë në vendimin nr. 568, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”</p> <p>27.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 165, datë 17.3.2021 Për disa shtesa në vendimin nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”</p> <p>28.Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 19.5.2021 Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të pronës së paluajtshme, me sipërfaqe prej 10 000 m², e llojit truall, ndodhur në zonën kadastrale 8561, me numër pasurie 1/911, në pronësi të Bashkisë Korçë..</p> <p>29.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 278, datë 12.5.2021 Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për mbështetjen e turizmit shqiptar për promovimin në tregjet ndërkombëtare post COVID-19</p> <p>30.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 12.5.2021 Për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 vje, status special”, aplikuesit “Marina AI” sh.p.k</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>31.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 2.6.2021Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për pagesën e studios për çështjen e anulimit të vendimit të arbitrazhit ICSID Case nr. ARB/14/26</p> <p>32.Vendim i Këshillit të Ministravenr. 331, datë 2.6.2021Përmiratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 1/68, zona kadastrale 3529, Bashkia Pogradec.</p> <p>33.Vendim nr. 438, datë 15.7.2021 “Për mbështetjen financiare për menaxhimin e mbetjeve në bashkitë e qarkut të Durrësit”</p> <p>34.Vendim i Këshillit të Ministravenr. 437, datë 15.7.2021Përdisa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 544, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për lejimin e përdorimit të brigjeve në funksion të realizimit të projektit investues strategjik ‘Green Coast’”, të ndryshuar.</p> <p>35.Vendimi Këshillit të Ministravenr. 477, datë, 30.7.2021Për miratimin e listës së llojeve të huaja invazive dhe përcaktimin e procedurave për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit.</p> <p>36.Vendimi Këshillit të Ministravenr. 478, datë 30.7.2021Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Hotel Chaonians DeLuxe</p> <p>37.Vendimi Këshillit të Ministravenr. 496, datë 30.7.2021Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Durrës për mbështetje financiare nga qeverisja qendrore për menaxhimin e mbetjeve;</p> <p>38.Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 4, datë 5.11.2021Për kërkesat dhe rregullat e kryerjes së procesit të inventarizimit të faunës së egër, teknikat e metodat që përdoren, formatin e dokumentacionit të inventarizimit e për publikimin e rezultateve të tij”</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>39.Udhëzimi nr. 4, datë 5.11.2021 “Për kërkesat dhe rregullat e kryerjes së procesit të inventarizimit të faunës së egër, teknikat e metodat që përdoren, formatin e dokumentacionit të inventarizimit e për publikimin e rezultateve të tij”.</p> <p>40.Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisitnr. 224, datë 21.10.2021 Për delegimin e kompetencave për nënshkrimin e marrëveshjes midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.</p> <p>41.Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 32, datë 26.1.2021 Për miratimin e rregullores mbi funksionimin e komisionit vlerësues të certifikimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar, si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i “Certifikatës paraprake” apo i “Certifikatës”.</p> <p>42.Urdhër i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 295, datë 18.6.2021 Për miratimin e “Protokollit të masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik”.</p> <p>Ministria gjatë vitit 2021 ka përgatitur RIA-n për projektligjetligjet e mëposhtme:</p> <p>1.Projektligji “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”;</p> <p>2.Projektligji “Për gazet serrë të florinuara”.</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka organizuar konsultime publike për plane strategji dhe legjislacion nëpërmjet platformës ëëë.konsultime.gov.al për 2 ligje dhe për 54 Vendime të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Gjithashtu për shkak të legjislacionit specifik që ka kjo Ministri për fushën e mjedisit, dëgjesat e publikut organizohen dhe për plane apo</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>programe apo udhëzime specifike që kanë ndikim në publik. Dëgjesat publikohen në faqen e Ministrisë në linkun https://turizmi.gov.al/konsultime-me-publikun/</p> <p>Agjensia Kombëtare e Mjedisit organizon dëgjesa me publikun për të gjitha aktivitetet që kanë ndikim në Mjedis. Informacion më të detajuar të ndarë në vite e gjeni në faqen e këtij institucioni https://akm.gov.al/publiku/</p> <p>Konsultimet online janë bërë gjatë vitit të pandemisë dhe gjatë vitit 2020, jo gjatë vitit 2021.</p> <ul style="list-style-type: none"> •Në faqen zyrtare të Ministrisë është postuar më datë 17.05.2021 njoftimi për subjektet që disponojnë strukturë akomoduese/shërbimi dhe dëshirojnë të aplikojnë për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi. Për informacion më të detajuar referuar linkut: https://turizmi.gov.al/njoftim-per-ushtrimin-e-veprimtarise-si-stacion-plazhi-2/ •Në faqen zyrtare të Ministrisë është postuar më datë 05.07.2021 njoftimi për aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi.Për informacion më të detajuar referuar linkut: https://turizmi.gov.al/njoftim-per-aplikimet-per-ushtrimin-e-veprimtarise-si-stacion-plazhi/ •Konsultimet publike të kryera gjatë vitit 2021 informacion më i detajuar sipas linkut të mëposhtëm: https://konsultimipublik.gov.al/documents/reports/Shtojca_5a_MTM.pdf •Në faqen zyrtare të Ministrisë është postuar më datë 7.10.2021 thirrja për Projektpropozimet në fushën e Turizmit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka shpallur thirrjet për përfitimin e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit nga data 07/10/2021 deri më datën 		
--	--	--	--	--	--

			<p>06/11/2021. Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është të forcojë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e sektorit të turizmit në Shqipëri, nisur edhe nga situata në të cilën ndodhet industria e turizmit për shkak të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni COVID 19, nevojitet fokusim në promovimin e destinancioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore vendase, si dhe duke diversifikuar me modele inovative produktet turistike, duke zhvilluar modele të reja të funksionimit të aktiviteteve detare dhe menaxhimit të vijës bregdetare. Linku i për më shumë detaje.</p> <p>https://turizmi.gov.al/thirrje-per-projektpropozime-ne-fushen-e-turizmit-3/</p> <p>Gjatë vitit 2021 nuk kemi punonjës të trajnuar për të drejtën e informimit, por vlen për t'u theksuar se një pjesë e punonjësve të Ministrisë, janë trajnuar pikërisht në këtë fushë, në kuadër të trajnimeve të kryera nga ASPA, si institucion përgjegjës për trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil të administratës publike. Këto trajnime janë pjesë e planeve vjetore të trajnimeve, që ASPA organizon periodikisht.</p> <p>Gjatë vitit 2021 nuk kemi punonjës të trajnuar në fushën e të dhënave të hapura (open data format).</p> <p>Plani i Integritetit për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është i publikuar në faqen zyrtare online të ministrisë në rubrikën Ministria-Struktura.</p> <p>https://turizmi.gov.al/plani-i-integritetit-te-ministrise-se-turizmit-dhe-mjedisit/</p> <p>Plani i Integritetit për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është miratuar në datën 26.04.2022. MTM është duke ndërmarrë masat e përcaktuara në Planin e Integritetit të programuara për zbatim brenda vitit 2022.</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka adresen zyrtare të publikuar, nëpërmjet së cilës vijnë pyetje dhe kërkesa.</p> <p>Gjatë vitit 2021 nuk kemi punonjës të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por vlen për t'u theksuar se një pjesë e punonjësve të Ministrisë, janë trajnuar pikërisht në këtë fushë, në kuadër të trajnimeve të kryera nga ASPA, si institucion përgjegjës për trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil të administratës publike. Këto trajnime janë pjesë e planeve vjetore të trajnimeve, që ASPA organizon periodikisht.</p> <p>Gjatë vitit 2021 nuk kemi punonjës të trajnuar për temat e anti-korrupsionit, të tilla si konflikti i interesit, parandalimi i korrupsionit, por vlen për t'u theksuar se një pjesë e punonjësve të Ministrisë, janë trajnuar pikërisht për këto tema, në kuadër të trajnimeve të kryera nga ASPA, si institucion përgjegjës për trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil të administratës publike. Këto trajnime janë pjesë e planeve vjetore të trajnimeve, që ASPA organizon periodikisht.</p> <p>Lista e punonjësve të institucionit nuk është e publikuar në faqen tonë zyrtare.</p>		
25.	31/05/2022	Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi për stacion plazhi.		Deleguar AKB-së.	Deleguar AKB-së	0

Qershor 2022

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
26.	01/06/2022	Kërkesë për informacion lidhur me procedurat e certifikimit per ekspert mjedisi.	16/06/2022	<p>Është miratuar ligji nr. 128/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar.</p> <p>Në zbatim të tij, ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të pikës 4, të nenit 24 të ligjit, i cili citon se “Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit. Ministri lëshon certifikatën”.</p> <p>Nga sa më sipër, pasi të jetë miratuar baza ligjore, e cila përcakton rregullat, procedurën dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bëjë njoftimin në faqen zyrtare të ministrisë për të gjithë personat e interesuar, në mënyrë që të marrin pjesë dhe të konkurojnë për pajisjen me certifikatën e ekspertit.</p>	Përfunduar	0
27.	02/06/2022	Kërkesë për informacion dhe vënie të dokumentacionit në dispozicion mbi dhenien e statusit investues strategjik për	10/06/2022	Deleguar prane AKZM	Përfunduar (Kthyer përgjigje nga AKZM)	0

		projektin e Investimit White Roads Hotel.				
28.	03/06/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e kategorizimit të hoteleve.	23/06/2022	<p>Marrja e markës ndërkombëtare për hotelet nuk është brenda juridiksionit administrativ që mbulon Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>1.Pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ndiqet procedura e klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”, kjo në mbështetje të Urdhrit të Ministrisë nr.243, datë 09.07.2019 “Për miratimin e rregullores mbi procedurën e klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”, i ndryshuar, si dhe procedura për dhënien e statusit “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje”, status special, mbështetur në VKM-në nr.257, datë 09.05.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të dokumentacionit për subjektet që aplikojnë për statusin “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje”, status special.</p> <p>Deri më tani janë klasifikuar 5 struktura akomoduese që mbajnë marka të njohura ndërkombëtare si dhe kanë marrë statusin special “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje”, status special.</p> <p>Për sa më sipër, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka kompetencë mbi procesin që ndjek subjekti privat për të siguruar markën ndërkombëtare.</p> <p>2.Referuar pyetjes 2 të kërkesës suaj, sqarojmë se procesi i inspektimit, bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 93/2015 për “Turizmin”, VKM nr. 730, datë 20.10.2016 “Për</p>	Përfunduar	0

				<p>miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit të Ministrit nr.243, datë 09.07.2019 “Për miratimin e rregullores mbi procedurën e klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”, i ndryshuar.</p> <p>3.Referuar pikës 3 të kërkesës, lidhur me kriteret për të fituar statusin e një marke ndërkombëtare, përgjigja e kësaj pyetje është ezauruar me argumentimin e dhënë në pyetjen e parë.</p>		
29.	06/06/2022	Kërkesë për informacion në vijim të disa shqetësimeve të ngritura nga subjekti VISAD Hotel.		Deleguar AKM-së	Deleguar AKM-së (kthyer përgjigje)	0
30.	16/06/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me monitorimin dhe zbatimin e ligjit që ndalon prodhimin, importimin dhe tregtimin e qeseve plastike njëpërdorimshme.	30/06/2022	<p>Në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 53/2020, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar, Ligjit Nr. 52/2020 për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar, Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, Ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Më datë 1 Qershor 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 28/2022 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10 463 “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”. Qëllimi i ndryshimeve të miratuara me</p>	Përfunduar	0

			<p>ligjin e mësipërm është reduktimi i plastikës njëpërdorimshe, konkretisht i prodhimit, përdorimit, importit dhe futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë së qeses plastike mbajtëse për qëllime transporti me trashësi të mureve të qeses për çdo anë më të vogël se 70 micron, me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 kilogramë dhe me përmasa më të vogla se 50 cm gjatësia dhe 24 cm gjerësia pa përfshirë gjerësinë e palosjeve.</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka deklaruar se pas fazës së informimit dhe të këshillimit, pas datës 1 Korrik 2022 grupet inspektuese do të nisin monitorimin për zbatimin e këtij ligji.</p> <p>Për sa më sipër ju bëjme me dije se Drejtoria e Inspektim Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit do të krijojë grupe pune, ku përkatësisht do të jetë nga një grup inspektimi për çdo rajon. Kontrollat do të kryhen bazuar në fushën e përgjegjësisë që ka Agjencia Kombëtare e Mjedisit sipas Vendim Nr. 367, datë 30.05.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjen në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”, ku në pikën 4 citohet se: Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të hollësishme për ndalimin e prodhimit të qeseve plastike mbajtëse. Kështu Agjencia Kombëtare e Mjedisit do të inspektojë operatorët të cilët janë mbajtës të një leje mjedisi Tipi B me specifikim sipas Ligjit Nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, me specifikim sipas shtojcës 1, ID 7.13 “Prodhim i produkteve prej plastike”.</p> <p>Për sa i takon vendosjes së gjobave ju informojmë se grupet e punës do të marrin masa në bazë të shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit në terren në operatorët që janë prodhues të qeseve plastike. Bazuar në Ligjin Nr. 28/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në pikën 4 të këtij ligji thuhet shprehimisht se masa e gjobës do të vijë duke u përshkallëzuar nga 500.000 (pesëqind mijë) dhe sekuestrim të qeseve plastike të ndaluara, deri në 1.500.000 (një million e pesëqind mijë) dhe sekuestrim të qeseve plastike të ndaluara dhe në rast konstatimi se operatori vazhdon hedhjen në treg të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, masat do të shkojnë deri në revokim të lejes/licencës së prodhimit dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara.</p> <p>Të ardhurat e mbledhura nga masa e marrë do të derdhen në Buxhetin e Shtetit, bazuar kjo në nenin 63, pika 9 të Ligjit nr. Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.</p>		
31.	21/06/2022	Kërkesë për Informacion ardhur nga Avokati i Popullit ne lidhje me një problematike te mjedisit, transmetuar ne Top Channel.	24/06/2022	Vënë në dispozicion dokumentet në rrugë zyrtare.	Përfunduar	0
32.	22/06/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me situatën e mbetjeve në Qarkun e Korçës.	4/7/2022	-Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me projektin KFË të qeverisë Gjermane, ka ndërtuar vend depozitimin rajonal të depozitimit të mbetjeve në shërbim të 6 bashkitë të këtij qarku. Ky vend depozitim aktualisht administrohet nga kompania aksionere nder bashkiakë KRËM, për një periudhë shfrytëzimi prej 20 – 25 vitesh.	Përfunduar	0

			<p>-Zona e lëndfilli Maliq ka një sipërfaqe rreth 73.700 m² ose (73.7 ha), dhe një impiant të trajtimit të ujërave të kullimit rreth 2.500 m² ose (0.25 ha). Ky vend depozitim nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është i pajisur me Leje Mjedisore dhe i cili plotëson standarde mjedisore, sipas legjislacionit në fuqi. Sipërfaqja e përgjithshme e vend depozitimit të mbetjeve përbëhet rreth 195.000 m² ose (19.5 ha).</p> <p>-Gjithashtu për bashkitë Devoll, Pogradec dhe Kolonjë janë ndërtuar qendra transferimi, për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve për riciklim dhe uljen e sasisë të depozitimit të mbetjeve, në lëndfillin Maliq.</p> <p>-Në zbatim të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar si dhe akteve të tjera ligjore në fuqi, grumbullimi, ndarja në burim, transportimi, trajtimi dhe asgjësimi i kontrolluar sanitar në lëndfill, është përgjegjësi e pushtetit vendor.</p> <p>-Në këtë kuadër në vitin 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit së bashku me përfaqësuesit e bashkive, qarku dhe Prefekturat, organizoi nismën “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”, e cila lindi si një nevojë për të njohur në thellësi gjendjen ekzistuese të vend depozitimeve në rrafsh kombëtar dhe për të adresuar një grup zgjidhjesh të përshtatshme për zbutjen e risqeve që këto infrastruktura shfaqin.</p> <p>-Mbështetur në VKM - në nr. 452, datë 11.07.2012 “Për lëndfilllet e mbetjeve” i ndryshuar, u hartua dokumenti sipas metodologjisë të këtij akti të rishikuar, për të bërë të mundur që bashkitë sot të arrijnë disa standarde për vend depozitimin e mbetjeve të tyre për një periudhë tranzitore deri në ndërtimin e lëndfilleve sipas Masterplanit.</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>-Në këtë dokument janë parashikuar ndërhyrjet që do të ndërmerren në zonat e mbetjeve të përcaktuar me efekte financiare, që do të parashikohen nga buxheti i bashkive apo pushtetit qëndror.</p> <p>-Gjithashtu për një vlerësim dhe një adresim më të qartë në fushën e menaxhimit të mbetjeve nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit miratoi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020 – 2035”, e cila synon të ndërlihdë gjithë aktorët dhe operatorët që përfshihen në këtë cikël, me qëllim përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në shëndetin e njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>-Në këtë lëndfill depozitohen mbetje urbane të gjeneruara nga bashkitë e Qarkut Korçë. Për marrjen e masave të menaxhimit të mbetjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit me anë shkresës “Kërkesë për marrje masash”, është drejtuar 61 Kryetarëve të bashkive, në të cilën është kërkuar që depozitim i mbetjeve urbane & inerte të bëhet në përputhje me legjislacionin kuadër të mbetjeve.</p> <p>-Aktualisht nga ana e institucioni të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat/ Elbasan/Korçë, nuk ka aplikuar masë administrative, për arsye se Bashkitë kanë reaguar pas shkresave tona për marrje masash.</p> <p>Informacion mbi inspektimin dhe shërbimin e menaxhimit të mbetjeve:</p> <p>Në zonën e Korçës subjekti privat i cili kryen shërbimin e grumbullimit, transportit dhe depozitim të mbetjeve të ngurta urbane në lëndfillin Maliq për Bashkinë Korçë, kryhet nga subjekti “Korsel” Sh.p.k. Për mos zbatimin e kushteve të</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>detyrimeve të lejes mjedisore, ndaj këtij subjekti janë marrë edhe masa administrative.</p> <p>Masat që do të vijojnë për gjatë periudhës 2022 nga AKM:</p> <p>Në kuadër të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit në zbatim të Urdhrit Nr.108, datë 20.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, dhe Urdhërit të Brëndshëm, me lëndë “Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e menaxhimit të mbetjeve urbane në Njësitë e Qeverisjes Vendore, evidentimin e mbetjeve të ngurta pranë akseve rrugore kombëtare dhe atyre që të çojnë në destinacionet turistike, monitorimin e shkarkimit të ujërave në vijën bregdetare, liqenore, krijimin e bazës së të dhënave për cilësinë e ujërave sipas kontratave të lidhura me institucionet shtetërore kompetente”. Aktualisht nga ana e strukturës të ARM Berat/Elbasan/Korçë dhe Lezhë, ka nisur inspektimi në të gjithë vendin.</p> <p>Ky inspektim ka si qëllim parandalimin monitorimin dhe zbatueshmërisë legjisacionit në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe të mjedisit në Njësitë e Qeverisjes Vendore, evidentimin e mbetjeve të ngurta pranë akseve rrugore kombëtare, për të garantuar një mjedis të pastër dhe një sezon turistik për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj.</p> <p>Në zbatim të pikës 3, të nenit 45 të ligjit 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, VKM – së nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020 – 2035”, dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 13.01.2020 “Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta” depozitimi i mbetjeve bëhet në lëndfill rajonal.</p>		
33.	25/06/2022	Kërkesë për informacion në	28/06/2022	Është percjellë informacioni i detajuar mbi kontratat e shfrytëzimit të pyjeve të lidhura para hyrjes në fuqi të ligjit nr.		

		lidhje me kontratat 10-vjeçare të pyjeve të lidhura nga Bashkia Librazhd.		5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë” të dërguar nga Bashkia Librazhd me shkresën me nr. prot. 61, datë 28.04.2022, protokolluar në AKP me nr. 352, datë 4.05.2022. (Kjo shkresë përmendet në shkresën me nr. prot. 2102/1, date 10.05.2022 të Bashkisë Librazhd drejtuar AKP të cilën ua kemi dërguar) (DOKUMENTAT BASHKËLIDHUR NË RRUGË ELEKTRONIKE)	Përfunduar	0
34.	27/06/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me nivelin e zhurmave në Tiranë.	27/06/2022	Ju informojmë se monitorimi i nivelit dhe kontrollit të zhurmave është fushe e përgjegjesise se Institutit te Shendetit Publik, prandaj lutemi t'i drejtoheni këtij institucioni për të marrë informacionin që ju kërkoni	Përfunduar (kthyer përgjigje që kërkesa t'i drejtohet ISHP-së)	0
35.	27/06/2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimet për pajisjen me certifikatën e vlerësimit të ndikimit në mjedis.	28/06/2022	Ne vijim te kërkesës tuaj për informacion, drejtuar Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit, ju bëjmë me dije se: Është miratuar ligji nr. 128/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar. Në zbatim të tij, ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të pikës 4, të nenit 24 të ligjit, i cili citon se “Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit. Ministri lëshon certifikatën”. Nga sa më sipër, pasi të jetë miratuar baza ligjore, e cila përcakton rregullat, procedurën dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe	Përfunduar	0

				auditimin mjedisor, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bëjë njoftimin në faqen zyrtare të ministrisë për të gjithë personat e interesuar, në mënyrë që të marrin pjesë dhe të konkurojnë për pajisjen me certifikatën e ekspertit.		
36.	28/06/2022	Kërkesë për informacion nga Citizens Chanel në lidhje me integrimin e Vjosës si Park Kombëtar.	06/07/2022	Vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar.	Përfunduar	0
37.	30/06/2022	Kërkesë për informacion drejtuar Ministres së Turizmit dhe Mjedisit për vënien në dispozicion të memorandumit të mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe organizatës amerikane “Patagonia” për shpalljen e lumit	04/07/2022	Vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar.	Përfunduar	0

		Vjosë “Park Kombëtar”.				
--	--	------------------------	--	--	--	--

Korrik 2022

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)		Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
38.	14/07/2022	Kërkesë për informacion nga Znj. Dorina Ndreka nëpërmjet portalit Pyetshtetin.al në lidhje me vënien në dispozicion të relacionit shoqërues të VKM-së Nr. 60, datë 26.1.2022.	14/07/2022	Vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar.	Përfunduar	0

39.	15/07/2022	Kërkesë për informacion nga MCN TV në lidhje me kontratën nr. 6597, datë 31.08.2017 ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Integrated Energy BV SPV sh.p.k.	18/07/2022	Ju informojmë se MTM ka transferuar te gjitha dosjet qe lidhen me kontratat pranë MIE. Lutemi qe kërkesa për informacion te shkoje pranë këtij institucioni.	Përfunduar	0
-----	------------	--	------------	---	------------	---

Gusht 2022

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)		Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
40.	02/08/2022	Kërkesë për informacion nga Birn Albania, në lidhje me Rezervatin Natyror të	06/08/2022	Deleguar tek AKZM	Përfunduar (Kthyer përgjigje nga AKZM)	0

		Menaxhuar Kune-Vain.				
41.	02/08/2022	Kërkesë për informacion nga Citizens Chanel në lidhje me me projektin e hidrocentralit të Skavicës.	8.8.2022	Deleguar tek MIE	Përfunduar	0
42.	03/08/2022	Kërkesë për informacion nga Faktoje.al në lidhje me kontrollet sa i përket mjeteve lundruese.	8.8.2022	Deleguar tek AKB	Përfunduar	0
43.	8/8/2022	Kërkesë për informacion nga gazetarja Dejtona Iseberi në lidhje me taksat që turistët paguajnë në vendin tonë dhe disa informacione të	10/8/2022	Ne vijim te kërkesës suaj për informacion, drejtuar Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit, ju bëjmë me dije si me poshtë vijon: 1.Ne lidhje me pyetjet 1 dhe 2, ju informojmë se nuk aplikohen taksa për turistet, përveç taksës se fjetjes ne hotele, për te cilën mund t`i referoheni kuadrit ligjor vendor ne linkun VKB-Nr.-59-date-30.12.15-Per-sistemin-e-Taksave-dhe-Tarifave-Vendore-ne-qytetin-e-Tiranes-i-ndryshuar.pdf (dpttv.gov.al). Për informacione me te detajuara mund te kontaktoni edhe ne zyrat e taksave vendore ne zonat bregdetare, te cilat kane edhe fluksin me te madh te pushuesve gjate periudhës se sezonit veror;	Përfunduar	0

		tjera për turizmin.		<p>2. Ne lidhje me pyetjen 3, bashkëlidhur do të gjeni një tabelë me 10 shtetet me numrin më të madh të vizitoreve në vendin tuje;</p> <p>3. Sa i përket pyetjes 4, bashkëlidhur do të gjeni linkun me informacione për sektorin e turizmit.</p> <p>https://turizmi.gov.al/statistikat-e-turizmit/</p>		
--	--	---------------------	--	---	--	--

Shtator 2022

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
44	13/09/2022	Kërkesë për informacion nga, në lidhje me kompaninë "B*****", për heqje nga fondi pyjor dhe leje mjedisi	19/09/2022	<p>Ju bëj me dije se shoqëria "B*****" nuk ka paraqitur kërkesë për heqje nga fondi pyjor lidhur me këtë aktivitet minerar dhe për pasojë nuk ka një akt të miratuar për të.</p> <p>Bashkëlidhur leja mjedisore dhe urdhri i pezullimit</p>	Përfunduar	0
45	16/09/2022	Ankimi ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe	19/09/2022	Kthyer përgjigje dhe me shkresë dhe në mënyrë elektronike.	Përfunduar	0

		kopje të dokumenteve zyrtar				
46	20/09/2022	Kërkesë për informacion nga Adisa, për subjektin: L**** and T** A****në lidhje me pajisjen me licencë për aktivitetin “Kurse dhe zhytje, turizëm detar”	21/09/2022	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sipas legjislacionit të turizmit detar dhe përkatësisht ligjit nr. 43/2020 "Për aktivitetet e turizmit detar", "Zhytje çlodhëse" përcaktohet si një nga aktivitetet turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi në vijën bregdetare, hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme në Republikën e Shqipërisë; 2. Po sipas ligjit nr. 43/2020 "Për aktivitetet e turizmit detar", aktivitetet e turizmit detar për qëllime çlodhëse dhe argëtuese, me përjashtim të peshkimit turistik, ofrohen vetëm nga operatorët e turizmit detar të licencuar si operator turistik në përputhje me legjislacionin për turizmin (VKM nr. 710, datë 12.10.2016 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik”), legjislacionin për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë (VKM nr. 827, datë 23.11.2016 "Për një shtesë në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” dhe parashikimet e vete këtij ligji; 3. Operatori i turizmit detar, pas licencimit si Operator Turistik, para fillimit të aktiviteteve të turizmit detar, duhet të pajiset me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së "Zhytje çlodhëse" sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 845, datë 28.10.2020 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike 	Përfunduar	0

				<p>dhe argëtimi", Udhëzimit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 4 , datë 31.12 2020, "Mbi kriteret dhe procedurën për certifikimin e operatorëve të turizmit detar" dhe Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 344, datë 31.12.2020 "Për miratimin e kodit të etikës për operatorin e turizmit detar dhe formatit të vetë deklaramit".</p> <p>Ndërkohë për aktivitetin e trajnimit për zhytje dhe qendra të zhytjes, sipas VKM nr. 321, datë 28.5.2014 "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", i ndryshuar, "Ministria përgjegjëse për turizmin në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare janë përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe kontrollin e rregullave për autorizimin e qendrave e të shkollave të trajnimit për zhytje sportive në përputhje me praktikat ndërkombëtare të sporteve ujore, duke siguruar që këto qendra të kenë pajisje të mjaftueshme, të jenë të organizuara dhe të kenë instruktorë të certifikuar".</p>		
47	23/9/2022	Kërkesë për dhënie informacioni nga gazetari A**** D**** në lidhje me landifillet	23/09/2022	<ul style="list-style-type: none"> • Për landfillin e Qarkut të Korçës dhe të Vlorës informojmë se është ndjekur procedura nga KFW dhe ish Ministria e Infrastrukturës. • Landfilli i Bajkajt është projektuar dhe financuar e ndjekur nga Banka Botërore dhe nga ish Ministria e Infrastrukturës dhe ish Ministria e Zhvillim Urban dhe me pas i është kaluar dokumentacioni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. 	Përfunduar	0

				<ul style="list-style-type: none"> • Për Landifillin i Bushatit, procedurat janë ndjekur nga ish Ministria e Infrastrukturës dhe studimi është bere me asistencë te huaj • informacioni për ndërtimin e landfillit te Durrësit, informojmë se në dijeninë tone nuk është zhvilluar procedure tenderimi dhe nuk ka pasur anulim te shpalljes se fituesit . 		
48	23.09.2022	Kërkesë për dhënie informacioni në lidhje me zonat e mbrojtura	23.09.2022	Kthyer përgjigje nga AKZM dhe e-mil dhe me shkrese	Përfunduar	0
49	26.09.2022	Kërkesë informacioni zyrtar nga dokumentet zyrtare: Kërkohet një kopje e raportit teknik	28/09/2022	Kthyer përgjigje me shkrese bashkëlidhur raportin teknik bashkëlidhur	Përfunduar	0
50	27.09.2022	Kërkese për informacion (nr i kërkesave adresuar komisionerit)	4.10.2022	https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/REGJISTRI-I-K%C3%8BRKESAVE-JANAR-SHTATOR-2022.pdf https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Regjistri-i-kerkesave-per-informacion-Janar-Dhjetor-2021.pdf	Përfunduar	0

51	28.09.2022	Kërkese për informacion e përsëritur	29.09.2022	Kthyer përgjigje nga AKM dhe MTM	Përfunduar	0
52	28.09.2022	Ankimi ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtar	3.10.2022	Kthyer përgjigje me e-mail dhe me shkresë zyrtare Numri i vizitoreve për periudhën Janar-Gusht 2022 ne zonat e mbrojtura ne Qarkun e Tiranës:62588	Përfunduar	0
53	30.09.2022	Kërkese informacioni ne lidhje me kriteret për pajisjen me certifikata udhërrëfyese turistik, dhe institucionet qe njihen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për trajnime	4.10.2022	Për pajisjen me certifikatë udhërrëfyese turistik, duhet te ndiqni programet e akredituara të kualifikimit të udhërrëfyesisit turistik të miratuara nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, për të përmbushur të gjitha modulet e kreditet e programit të miratuar, referuar udhëzimit të përbashkët nr. 517, datë 24.01.2017, “Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesisit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim”. Me shume informacion në lidhje me programet e akredituara e gjeni ne linkun: https://turizmi.gov.al/njoftim-mbi-akreditimet-e-programeve-te-kualifikimit-te-udherrefyesisit-turistik/	Përfunduar	0

Tetor 2022

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
54.	04.10.2022	Kërkesë për informacion për relacionet shoqëruese mbi vkm e miratuara katër mujorin e pare te vitit 2022, ku propozues ka qen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	11.10.2022	Kthyer përgjigje bashkëlidhur informacion e kërkuar	Përfunduar	0
55	10.10.2022	Kërkesë për informacion për relacionet shoqëruese mbi vkm e miratuara në periudhën Maj-Shtator 2022 me propozim te Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit	20.10.2022	Në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “ Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.584, datë 28.08.2003 “ Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” i ndryshuar, përcaktohet se, projekt aktet së bashku me relacionin shoqërues depozitohen në Këshillin e Ministrave për miratim	Përfunduar	0
56	11.10.2022	Kërkesë për informacion: 1.Sa është niveli I ndotjes së ajrit në qytetin e Korçë gjatë periudhës së dimrit krahasuar me qytetet e tjera të vendit por edhe me normat e lejuara të BE? 2. Në çfarë afatesh kohore kryhen matjet e parametrave të ajrit?	14.10.2022	1. Sa është niveli i ndotjes së ajrit në qytetin e Korçe gjatë periudhës së dimrit krahasuar me qytetet e tjera të vendit por edhe me normat e lejuara të BE? AKM kryen monitorimin e cilësisë së ajrit urban në 6 qytete kryesore të vendit tonë me anë të 7 stacioneve automatike ku njëri nga stacionet është	Përfunduar	0

		<p>3. A janë funksionale stacionet e matjes në qytet, sa stacione ka dhe në cilat zona janë vendosur?</p> <p>4. Nga mbledhja e të dhënave çfarë strategjie ka hartuar Ministria e Mjedisit për të minimizuar ndotjen?</p> <p>5. Ku konsistojnë këto politika dhe a ka projekte konkrete të zbatuara në Korçë?</p> <p>6. Përgjegjësia për reduktimin e ndotjes së ajrit a është ndarë mes institucionesh dhe si janë përgjigjur ato konkretisht në përmbushjen e detyrimeve për mbrojtjen e mjedisit?</p>		<p>automatik Mobile, në qytetet Tiranë ,Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Korçë. Në qytetin e Korçës stacioni është instaluar në oborrin e shkollës “Raqi Qirinxhi”.</p> <p>Ndër vite Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka monitoruar cilësinë e ajrit urban në këtë qytet ku vërejmë që kemi rritje të treguesve të PM10 dhe PM2.5 mbi normën e BE dhe ligjit shqiptar vetëm në periudhën e dimrit. Kjo ndotje vjen si rezultat i përdorimit të druve të zjarrit për ngrohje në këtë qytet.</p> <p>2. Në çfarë afatesh kohore kryhen matjet e parametrave të ajrit?</p> <p>Për realizimin e procesit të monitorimit janë zbatuar metodat standarde sipas të cilave përcaktohen mesataret kohore të monitorimit të cilësisë së ajrit, bazuar në direktivën CAFE të BE për një ajër të pastër dhe kërkesave të EEA për raportimet. Stacionet e monitorimit janë statike. Matjet janë 24-orëshe pajisjet që përdoren janë stacione automatikë që përmbushin kushtet e Direktivës së ajrit urban.</p> <p>3. A janë funksionale stacionet e matjes në qytet, sa stacione ka dhe në cilat zona janë vendosur?</p> <p>Në qytetin e Korçës, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka një stacion monitorimi i cili është vendosur në oborrin e shkollës ‘Raqi Qirinxhi’ Për momentin stacioni automatik i monitorimit të cilësisë së ajrit urban nuk është funksional.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>AKM në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit po bashkëpunojnë për vënien në efencë të plotë të stacioneve të monitorimit të ajrit urban deri në fund të këtij viti.</p> <p>4.Nga mbledhja e të dhënave çfarë strategjie ka hartuar Ministria e Mjedisit për të minimizuar ndotjen? Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hartuar Planin Kombëtar i Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedis, i miratuar me Vendimin nr.123, datë 17.2.2011 të Këshillit të Ministrave.</p> <p>5. Ku konsistojnë këto politika dhe a ka projekte konkrete të zbatuara në Korçë? Projektet janë në kompetencën të pushtetit vendor.</p> <p>6. Përgjegjësia për reduktimin e ndotjes së ajrit a është ndarë mes institucioneve dhe si janë përgjigjur ato konkretisht në përmbushjen e detyrimeve për mbrojtjen e mjedisi ? Agjencia Kombëtare e Mjedisit monitoron cilësinë e ajrit urban dhe të dhënat dërgohen në Agjencitë Rajonale të Mjedisit si dhe Pushtetit Lokal për të marrë masa lidhur me problematikat e identifikuar.</p>		
57	11.10.2022	Kërkesë për informacion: 1. Sa është numri total i personave që kanë aplikuar në skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit të tyre gjatë	19.10.2022	Lidhur me sa kërkonte ju informojmë se përzgjedhja e projekteve bëhet në mbështetje të ligjit 93/2015 “Për turizmin”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016 “Për caktimin e kriterëve e të afateve të kërkesë	Përfunduar	0

		<p>periudhës janar-dhjetor 2021? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj?</p> <p>2. Sa është numri i të rinjve (15-29) që kanë aplikuar në skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit të tyre gjatë periudhës janar-dhjetor 2021? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj?</p>		<p><i>propozimeve për mbështetje financiare në fushën e turizmit”.</i></p> <p>2. Sqarojmë edhe njëherë se, referuar pikës 2 të VKM të sipërpërmendur, ku citohet se “<i>Ministria përgjegjëse për turizmin për zgjedh projektet në fushën e turizmit duke vlerësuar ndikimin social, mjedisor dhe ekonomik të tyre</i>” si dhe pikës 5 ku thuhet se “<i>Projektet do të përzgjidhen, do të synojnë a) përgatitjen e studimeve apo te modeleve te produkteve turistike b) promovimin e studimeve turistike e te vlerave te trashëgimisë natyrore dhe kulturore te vendit c) zhvillojnë veprimtari ne fushën e turizmit, me qellim rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit</i>, projektet nuk kanë për qëllim ngritjen e biznesit por promovimin e turizmit.</p> <p>3. Referuar pyetjes se sa është numri total i personave që kanë aplikuar, ne kuadër të thirrjes për mbështetje financiare, ju informojmë se, numri i subjekteve që kanë aplikuar për vitin 2021 është 73.</p> <p>- Presa i përket të dhënave të aplikativë, konkretisht moshës edhe gjinisë, ju bëjmë me dije se pjesë e thirrjes mund të jeni personat fizik por edhe juridik, të cilët janë në formën e SHPK-ve, SHA-ve dhe OJF-ve, dhe si e tillë nuk mund të bëjmë identifikimin e të dhënave të kërkuara nga juaj.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

58	12.10.2022	<p>Kërkesë per informacion: A ka një drejtori IT-je ministria? Nëse po më vini në dispozicion të dhënat për drejtorinë përkatëse.</p> <p>Nëse jo, ju lutem më vini në dispozicion arsyet pse nuk ka një drejtori të tillë në Ministrinë tuaj?</p> <p>Cilat kanë qenë investimet në sigurinë kibernetike në 5 vitet e fundit?</p>	13.10.2022	<p>Referuar pyetjes së pare ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Në strukturën e Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit nuk ka drejtori IT, për me shume informacion në linkun https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/STRUKTURA-MTM.pdf gjeni strukturën e ministrisë.</p> <p>Referuar pyetjes së dytë ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Referuar VKM-Nr.-673-datë-22.11.2017-e-ndryshuar, drejtoritë e IT-së, i kanë kaluar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.</p>	Përfunduar	0
59	13.10.2022	<p>Kërkesë për informacion Bashkia Lezhë: Për projektin ‘Për rehabilitimin e shëtitores mbi lumin Drin’</p>	19.10.2022	<p>Për rehabilitimin e shëtitores mbi lumin Drin” ju informojmë se, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk disponon dokumentacion në arkivin e saj në lidhje me këtë projekt.</p> <p>Ky projekt është ndjekur nga Ish Drejtoria Pyjore Lezhë strukturë e cila me VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/ Bashkive”, i ndryshuar, ka kaluar pranë Bashkisë Lezhë.</p>	Përfunduar	0

				Sa i përket dokumentacionit të kësaj strukture ju sqarojmë se, bazuar në urdhrin e Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit nr.63. datë 23.02.2021, rrjeti arkivor i Ish Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë i ka kaluar Bashkisë Lezhë.		
60	14.10.2022	kërkesë për informacion	14.10.2022	Deleguar AKZM	Përfunduar	0
61	18.10.2022	<p>Kërkesë për informacion mbi ndikimin në mjedis të pesticideve dhe kimikateve të tjera që përdoren në bujqësi</p> <p>1. Raportet vjetore për kimikatet të 5 viteve të fundit si pjesë e Raportit për Gjendjen e Mjedisit.</p> <p>2. Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë</p> <p>3. A ekziston dhe si mund ta aksesoj Regjistrin Elektronik të Kimikateve ku prodhuesit dhe importuesit janë të detyruar, sipas ligjit, të raportojnë.</p> <p>4. Si e informoni ju publikun për rreziqet nga përdorimi i kimikateve?</p> <p>5. A ka prodhues kimikatesh bujqësore në Shqipëri?</p>	25.10.2022	<p>1-Raportet vjetore për kimikatet të 5 viteve të fundit si pjesë e Raportit për Gjendjen e Mjedisit, (RGJM).</p> <p>-Tek Raporti i Gjendjes të Mjedisit 2021, Kapitulli VIII, Ndotja nga kimikatet pika 8.2.25, Përdorimi i kimikateve në bujqësi faqe 157-159. - Tek Raporti i Gjendjes të Mjedisit 2020 Aneksi I, Të dhënat mjedisore sipas bashkive, Faqe 195-225, pjesa për bujqësinë ka informacion në lidhje me sasinë vjetore e plehrave kimike dhe kimikateve për përdorim bujqësor për çdo qark të Shqipërisë . Për çdo të dhënë tjetër në lidhje me Raportin e Gjendjes në Mjedis, RGJM,si raporte të publikuara nga AKM –ja, ju lutem gjeni në linkun zyrtar të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit(AKM-së). https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/</p> <p>2.Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë.</p> <p>Në lidhje me këtë pikë ju lutem shikoni Vendim Nr. 489, datë 29.6.2016 Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (svhc) e të kritereve për përfshirjen e substancave në listën svhc dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të</p>	Përfunduar	0

		<p>6. Raportet, të 5 viteve të fundit, nëse keni kryer, ose të fundit në kohë që mund të jetë kryer edhe para 5 vitesh, për ndotjen e tokës, ujërave dhe ajrit nga përdorimi i pesticideve dhe kimikateve në bujqësi.</p> <p>7. Një hartë nëse keni, ose një listë të zonave më të ndotura, ose më të rriskuara nga ndotja prej pesticideve dhe fertilizuesve, në Shqipëri, aktualisht.</p> <p>8. Ku konsiston veprimtaria e Ministrisë suaj, për shmangien ose minimizimin e dëmit që i shkaktohet mjedisit nga përdorimi i pesticideve dhe fertilizuesve.</p>	<p>svhc-ve, informacionin e gjeni ne linkun: https://akm.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/LISTA-VKM-489-date-29.06.2016_-SVHC.pdf</p> <p>3.A ekziston dhe si mund ta aksesoj Regjistrin Elektronik të Kimikateve ku prodhuesit dhe importuesit janë të detyruar, sipas ligjit, të raportojnë. Si detyrim i dalë nga zbatimi i Ligjit të Nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” Neni 27, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) janë duke bashkëpunuar për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Kimikateve, që do të menaxhohet nga Sektori i Kimikateve, ku secili prodhues apo importues do të raportojë të dhëna në lidhje me kimikatet.</p> <p>4. Si e informoni ju publikun për rreziqet nga përdorimi i kimikateve? Në kuadër të ligjit Nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.23, datë 03.02.2020, Për “Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, është krijuar Zyra e Kimikateve, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Si autoritet shtetëror kompetent Zyra e Kimikateve informon publikun në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për rreziqet që vijnë nga kimikate përmes identifikimit më të mirë dhe të hershëm të</p>		
--	--	---	---	--	--

			<p>vetive të brendshme të substancave kimike. Kjo bëhet konkretisht nga katër procese, përkatësisht, regjistrimi, vlerësimi, autorizimi dhe kufizimi i kimikateve me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Për ti ardhur në ndihmë publikut për rreziqet nga kimikatet Zyra e Kimikateve ka krijuar një platforme informacioni Helpdesk që mund të aksesohet ndërmjet linkut https://akm.gov.al/ Rubrika Kimikatet . Këtu publiku mund të gjejë informacione të ndryshme në lidhje me legjislacionin e kimikateve, në lidhje me kimikatet dhe mjedisin, biocidet, pesticidet dhe shumë informacione të tjera të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti me kimikatet dhe rreziqet që vinë nga përdorimi i tyre. Gjithashtu në dispozicion të publikut është dhe adresa e e-mail info.kimikatet@akm.gov.al dhënia e suportit për palët e interesuara në fushën e kimikateve, informacioneve të ndryshme në lidhje me legjislacionin e kimikateve, informacione në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me përdorimin e kimikateve.</p> <p>5. A ka prodhues kimikatesh bujqësore në Shqipëri?</p> <p>Prodhues të kimikateve bujqësore të kimikateve në Shqipëri nuk ka, ka vetëm subjekte që bëjnë ripaketimin dhe ambalazhimin e kimikateve bujqësore.</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>6. Raportet, të 5 viteve të fundit, nëse keni kryer, ose të fundit në kohë që mund të jetë kryer edhe para 5 vitesh, për ndotjen e tokës, ujërave dhe ajrit nga përdorimi i pesticideve dhe kimikateve në bujqësi.</p> <p>Nuk është bërë një vlerësim i tillë në atë kohë sa Sektori i Kimikateve ka qenë funksional dhe nuk ka publikime të raporteve për ndotjen e tokës, ujërave dhe ajrit nga përdorimi i pesticideve dhe kimikateve në bujqësi.</p> <p>7. Një hartë nëse keni, ose një listë të zonave më të ndotura, ose më të riskuara nga ndotja prej pesticideve dhe fertilizuesve, në Shqipëri, aktualisht.</p> <p>Në lidhje me këtë pikë ju lutem gjeni informacion në RGJM-në e vitit 2021 Kapitulli VIII, Pika 8.2 Vlerësimi i gjendjes, Kimikatet nga industria, faqe 154, publikuar në faqen zyrtare të AKM bashkëngjitur linku, https://akm.gov.al/ova_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2021/</p> <p>8. Ku konsiston veprimtaria e Ministrisë suaj, për shmangien ose minimizimin e dëmit që i shkaktohet mjedisit nga përdorimi i pesticideve dhe fertilizuesve</p> <p>Bazuar tek ligji Nr.27/2016 “Për menaxhimin e Kimikateve neni 26 Për planin e sigurt të kimikateve, MTM së bashku me institucionet e tjera të përfshira për zbatimin e këtij ligji, në datën 22.09.2022 u bë mbledhja e parë për hartimin e dokumentit të Planit Kombëtar për Menaxhimin e</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>Sigurt të Kimikateve . Hartimi i plotë i këtij dokumenti kërkon një periudhë 1-vjecare dhe është në fuqi për një periudhë 5-vjecare. Tek ky dokument do paraqitet hapat e ndërmarrë nga çdo institucion për minimizimin e riskut të përdorimit të kimikateve përfshirë këtu pesticidet dhe fertilizuesit. Në këtë moment ky dokument është në fazat e para të hartimit të tij. Në lidhje me këtë pikë, MTM dhe Sektori i Kimikateve si njësi funksionale e MTM, ka në fuqi dhe në zbatim Vendim Nr. 488, datë 29.6.2016 Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, në lidhje me klasifikimin e kimikatit, etiketimin e tij, fletën me të dhënat e sigurisë MSDS, ndalimin e kimikatit dhe kufizimin me anë të publikimit të listës së kimikateve të ndaluara dhe listës kandidatë Vendim Nr. 222 datë 07.04.2021 Për miratimin e Listës Së Substancave kandidatë.</p> <p>Gjithashtu në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ka një strukturë që mbulon çështjen e kimikateve ajo është Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit.</p>		
62	19.10.2022	<p>Kërkesë për informacion dhe venie në dispozicion dokumentacionin për sa më poshtë:</p> <p>1. Procedurat e njekura per VNMS per Projektin e hidrocentralit te HEC Skavice si dhe dokumentacionin perkates.</p>	26.10.2022	<p>Se për HEC Skavica nuk ka aplikim pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit</p>	Përfunduar	0

		<p>2. Aktet nga ministria e Mjedisit per VNMS per projektin e hidrocentralit HEC Skavice.</p> <p>3. A jane procedurat per VNMS per projektin e hidrocentralit HEC Skavice ne perputhje me problematikat dhe rekomandimet ne Progres Raportin e BE per Shqiperine, ne perputhje me konventen e Arhus (lidhja https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en. konkretisht faqe 109) ku thuhet:</p> <p>Such investments require full compliance with the national legislation as well as with the environmental and Energy Community acquis, and notably with regard to public consultations (Aarhus Convention) and quality of EIAs and SEAs.</p> <p>4. Cilat jane hapat e metejshme te Ministrise ne lidhje me fazen e pare te projektit te hidrocentralit te Skavicesë</p>				
63	20.10.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me të	2.11.2022	Referuar pyetjes se sa është numri total i personave qe kane aplikuar, ne kuadër te thirrjes për mbështetje financiare, ju informojmë se, numri i	Përfunduar	0

		<p>dhënat përfituesit nga skema e aplikimit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa është numri total i personave që kanë aplikuar në skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit të tyre gjatë periudhës janar-dhjetor 2021? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? 2. Sa është numri i të rinjve (15-29) që kanë aplikuar në skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit të tyre gjatë periudhës janar-dhjetor 2021? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? 		<p>subjekteve që kanë aplikuar për vitin 2021 është 73.</p> <p>- Përsa i përket të dhënave të aplikanteve, konkretisht moshës edhe gjinisë, ju bëjmë me dije se pjesë e thirrjes mund të jeni personat fizik por edhe juridik, të cilët janë në formën e SHPK-ve, SHA-ve dhe OJF-ve, dhe si e tillë nuk mund të bëjmë identifikimin e të dhënave të kërkuara nga juaj.</p> <p>Gjithashtu gjeni linkun me projektet e përzgjedhurat: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/Projektet-e-P%C3%ABrzgjedhura-2.pdf</p>		
64	25.10.2022	<p>Kërkesë për informacion: ku mund të gjej raportin 2-vjeçar që RGJM 2021 i referohet për ndryshimet klimatike, me saktësisht: Raporti dy-vjeçar i përditësuar për Shqipërinë botuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit “ Republika e</p>	27.10.2022	<p>https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Botimi-i-pare-shqip.pdf</p>	Përfunduar	0

		Shqipërisë: Aktivitete mundësuese për përgatitjen e Komunikimit të Katërt Kombëtar dhe Raportit të Parë Dyvjeçar të Përditësuar, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike” të zbatuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PKBZH), me mbështetjen financiare të Fondit Global për Mjedisin (FGM).				
--	--	--	--	--	--	--

Nëntor 2022

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
65	1.11.2022	Kërkesë për informacion: 1. Ka subjekte të specializuara të licencuara në Shqipëri për djegien	10.11.2022	1-Nga verifikimi në sistemin elektronik të QKB-së me emrin "pesticide", dalin vetëm subjekte të pajisur me Leje Mjedisit të tipi C , "magazininim i kimikateve dhe pesticideve".	Përfunduar	0

e pesticideve të skaduar dhe lëndëve apo materialeve të tjera bujqësore të destinuar për asgjësim? Cilat janë ato?

2. Çfarë ndodh realisht me këto produkte në Shqipëri?
3. Si dhe ku janë trajtuar ambalazhet e kontaminuara të PMB-ve të klasifikuara si të rrezikshme dhe shumë të rrezikshme gjatë 5 viteve të fundit? Sasia e tyre.

Lista e subjekteve me veprimtari "Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme".

Lista e subjekteve me Leje mjedisore per incenerimin e mbetjeve te rrezikshme

Subjekti	Aktiviteti	Tipi A	Tipi B	Tipi III - 2B
BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD LC-3250	Tipi A: Incenerim i mbetjeve te rrezikshme ne një instalim incenerimi, asgjësimi i mbetjeve te rrezikshme përveç incenerimit	Tipi A		

				UZI NA E LEN DEV E PLA SES E L C - 7418	<p>Tipi A: Prodhim i lendeve plasëse (lendeve plasëse për përdorim civil dhe ushtarak). Incenerim i mbetjeve të rrezikshme.</p>	Tipi A				
				ECO RICI KLI M	<p>Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafsheve. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme.</p>	Tipi A				
				ME DI- TEL	<p>I.D 5.1/a Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi, I.D 5.1/c Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç</p>	Tipi A				

				<p>atij të referuar në pikën 5.1/a I.D 5.6/a Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren I.D 5.10/a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart. I.D 5.10/b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart</p>				
				<p>Eco Rici klim Sh.p .k LC 0289</p> <p>ID 5.1/a Incenerimi I mbetjeve te rrezikshme ne një instalim incinerimi</p>	Tipi A			
				<p>V.A. L.E Recyclin g</p> <p>ID 5.1/a Incenerimi I mbetjeve te rrezikshme ne nje</p>	Tipi A			

				Sh.p .k LC 0914	instalim incinerimi				
<p>2-Pesticidet e skaduara klasifikohen si mbetje të rrezikshme, si rrjedhojë zbatohet VKM Nr.371 datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.</p> <p>Asgjësimi përfundimtar i tyre i nënshtrohet procesit të incenerimit.</p> <p>3-Sektori i Kimikateve, në bazë të VKM-së Nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave , përmbajtjen, përditësimin, publikimin e statistikave të mbetjeve" autoriteti kompetent për grumbullimin e PMB-ve është AKU në varësi të MBZHR.</p> <p>Kimikatet që përdoren në bujqësi, rregullohen nëpërmjet Ligjit nr 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 17/2020 “Për produktet plehëruese”, për të cilat autoriteti kompetent përgjegjës është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). Ne zbatim të ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve", Neni 30, parashikon</p>									

				<p>se: Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi mb ledhin, ruajnë dhe nxjerrin jashtë përdorimit, në mënyrë të sigurt, mbetjet e kimikateve të rrezikshme dhe paketimet e tyre, në përputhje me legjislacionin mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni dhe shkresën përcjellje për kompetencë të Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila do ju përcillet edhe zyrtarisht dhe në rrugë shkresore.</p>		
66	2.11.2022	<p>Kërkesë për informacion: • Kopje të praktikave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (propozimi dërguar KKT, dhënie opinionit/mendimi, projekt propozimi dërguar Këshillit të Ministrave, etj), para miratimit të Vendimit Nr.10 datë 28.12.2020 të KKT-së “Për miratimin e kufijve të zonave të mbrojtura” dhe para miratimit të VKM Nr. 59, datë 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”;</p> <p>• Kopje të VNM-eve përkatëse për ndryshimin e zonave të</p>	14.11.2022	<p>Presa i përket kërkesës tuaj, për piken e dyte "Kopje të VNM-eve përkatëse për ndryshimin e zonave të mbrojtura hartuar para dhe në kuadër të nxjerrjes së VKM-së Nr. 59, datë 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”, Ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <p>Në Ligjin Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 3, Fusha e zbatimit, përcaktohet se “Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.</p>	Përfunduar	0

		<p>mbrojtura hartuar para dhe në kuadër të nxjerrjes së VKM Nr. 59, datë 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopje të konsultimeve publike të kryera në kuadër të VKM Nr. 59, datë 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”. 		<p>Pra, në bazë të Shtojcave I dhe II, të këtij ligji, studimi për “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore””, nuk i nënshtrohet procedurës së VNM-së.</p> <p>Ndërsa për dy pikat e tjera e-maili është deleguar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në datë 2.11.2022 me e-mail.</p>		
67	02.11.2022	<p>Kërkesë për informacion:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kopje të listës së ekspertëve të licencuar për VNM; -Kopje të listës së ekspertëve të licencuar për VSM. 	14.11.2022	Bashkëlidhur është dërguar lista me e-mail	Përfunduar	0
68	03.11.2022	<p>Kërkesë për informacion: mund të me saktësoni prej sa kohesh funksionon Sektori i Kimikateve?</p> <p>Cili institucion mund të ma thotë nëse është bere, kur dhe çfarë rezultatesh ka pasur nje vleresim i përgjithshëm i ndikimit te</p>	09.11.2022	<p>Ju lutem mund të me saktësoni prej sa kohesh funksionon Sektori i Kimikateve?</p> <p>Zyra e Kimikateve është krijuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 23 datë 03.02.2020. “Për</p>	Përfunduar	0

		<p>pesticideve ne mjedisin shqiptar para se te funksiononte Sektori i Kimikateve nëse nuk mund te me informoni ju?</p> <p>Dhe nëse një studim i tille mungon ose mungon prej shume kohesh, cila është arsyeja?</p> <p>Ju lutem me thoni planifikoni nje vlerësim, studim për ndikimin e pesticideve ne mjedis dhe kur është planifikuar? Nga do te financohet?</p>		<p>Miratimin e Strukturës dhe Organikës të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.</p> <p>Baza ligjore mbi të cilën operon Zyra e Kimikateve është si më poshtë:</p> <p>1-Ligj Nr. 27/2016 për ”Menaxhimin e Kimikateve”</p> <p>2-Vendim Nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”</p> <p>3- Vendim Nr. 489, datë 29.6.2016”Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (svhc) e të kriterëve për përfshirjen e substancave në listën svhc dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të svhc-ve”</p> <p>4-Vendim Nr. 665, datë 21.9.2016 Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme</p> <p>5-Vendim Nr. 9, datë 9.1.2019 Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë</p> <p>6-Vendim Nr. 319, datë 15.5.2019 Për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe Përdorimin</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të Rrezikshëm</p> <p>7- Vendim Nr. 161, datë 19.2.2020 Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti</p> <p>8- Ligj Nr.10 277, datë 13.5.2010 Për aderimin e republikës së shqipërisë në konventën e Roterdamit “mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare”</p> <p>9- Ligj Nr.9263, datë 29.7.2004 Për ratifikimin e “konventës së Stokholmit “për ndotësit organikë të qëndrueshëm””</p> <p>10- Vendim Nr. 360, datë 29.4.2015 Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre</p> <p>11- Ligj Nr. 7/2020 Për ratifikimin e konventës së Minamatës “për merkurin”</p> <p>12-Vendim Nr. 442, datë 26.6.2019 Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të Merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>metalik dhe të kritereve specifike të ruajtjes së merkurit metalik të Konsideruar si mbetje.</p> <p>Zyra e Kimikateve është përgjegjëse për:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ndjekjen zbatimin e akteve ligjore qe kane te bëjnë me ligjin për menaxhimin e kimikateve dhe akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj dhe amendimet e tij; - mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në zbatim të tij, - koordinimin ndërinstytucional lidhur me menaxhimin e integruar të kimikateve; - bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me menaxhimin e kimikateve; - krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit kombëtar të kimikateve, përgatitjen e procedurave për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit; - publikimin e Listës së SVHC dhe Listës Kandidate; - lëshimin e autorizimeve për përdorimin e mëtejshëm të SVHC. - propozimin e heqjes së kimikateve nga tregu ose kufizimin e përdorimit të tyre kur përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin; 		
--	--	--	---	--	--

				<p>- shërbimin e informacionit (helpdesk) për të ofruar këshilla për prodhuesit, importuesit, përdoruesit e tjerë dhe çdo palë tjetër të interesuar mbi përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre përkatëse në bazë të këtij ligji;</p> <p>- informimin e publikut të gjerë në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për rreziqet që vijnë nga kimikatet kur konsiderohet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit;</p> <p>- plotësimin e detyrimeve lidhur me Konventat dhe Marrëveshjet e tjera Ndërkombëtare mbi Menaxhimin e Kimikateve (Konventa e Stokholmit, Konventa e Roterdamit, Protokollet e CLRTAP).</p> <p>Angazhimi i Zyrës së Kimikateve konsiston në shqyrtimin e Dokumentacionit më të Dhënat e Sigurisë (Material of Safety Data Sheet), formatin e MSDS, periudhën kur është përgatitur/rishikuar ky dokument, informacionin që gjendet në përmbajtje të tij, verifikimin e klasifikimit të substancës kimike në MSDS me atë të listës së harmonizuar aktualisht në Bashkimin Evropian, verifikimin dhe evidentimin rast pas rasti nëse subjektit importues i linden detyrime të tjera sipas legjislacionit në fushën e kimikateve etj. Në rastin e kimikateve të rrezikshme, shqyrtohet edhe nëse etiketa e paraqitur nga subjektit është në përputhje me parashikimet e bazës ligjore, si dhe</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>jepen rekomandime që reflektohen në përmbajtjen e etiketës së produktit.</p> <p>Cili institucion mund të ma thotë nëse është bërë, kur dhe çfarë rezultatesh ka pasur një vlerësim i përgjithshëm i ndikimit të pesticideve në mjedisin shqiptar para se të funksiononte Sektori i Kimikateve nëse nuk mund të më informoni ju?</p> <p>Dokumenti i fundit i përgatitur nga MTM lidhur me kimikatet dhe ndikimin e tyre në mjedis, është Plani kombëtar i veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm (NOQ/POPs), i përgatitur në kuadër të Konventës së Stokholmit, të cilin e gjeni këtu https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-505-2018-NOQ.pdf. Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm, janë një grup kimikatesh që kanë gjetur përdorim gjerësisht në të kaluarën, nder të tjera edhe në sektorin e bujqësisë.</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Ne dijeninë tone, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, se fundmi, ka përgatitur dy dokumentet si me poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. "PLANI I VEPRIMIT PËR PËRDORIMIN E QËNDRUESHËM TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE NË SHQIPËRI PËR VITET 2022-2032 " (konsultimipublik.gov.al) <p>2. VKM nr. 460, datë 29.6.2022, PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE PESHKIMIT, 2021–2027; e gjen ne këtë link: Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare (qbz.gov.al)</p> <p>Dhe nëse një studim i tillë mungon ose mungon prej shume kohesh, cila është arsyeja?</p> <p>Dokumente te tillë zakonisht përgatiten si detyrim ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare ne fushën e mjedisit dhe për shkak te kostos se larte qe kane, mbështeten nga donatore, mekanizma te huaj financues.</p> <p>Ju lutem me thoni planifikoni një vlerësim, studim për ndikimin e pesticideve ne mjedis dhe kur është planifikuar? Nga do te financohet?</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Me qellim përmbushjen e detyrimeve që i lindin vendit tone ndaj Konventës së Stokholmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit para pak kohësh shprehu interes për tu bërë pjesë e projektit të UNEP “Zhvillimi global, rishikimi dhe përditësimi i planeve kombëtare të veprimt (PKV) sipas konventës së Stokholmit për ndotësit organik të qëndrueshëm (NOQ-të) - shtetet shitesë të projektit 10785”, i cili tashme është miratuar nga GEF dhe bazuar në informacionin që disponojmë pritet të fillojë së shpejti.</p> <p>Në lidhje me kërkesën për tu njohur me raportin 2 vjeçar në lidhje me Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimaterike, ju lutem gjeni bashkëngjitur e-mailit dokumentin pdf.</p>		
69	4.11.2022	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare	9.11.2022	Kthyer përgjigje në rrugë zyrtare	Përfunduar	0
70	07.11.2022	Kërkesë për informacion: . Kopje e plotë e Urdhrit të përbashkët, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr. 311, dt. 9. 9. 2019.	7.11.2022	Në vijim të kërkesës tuaj ju bej me dije se Urdhri i përbashkët i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr. 311, dt. 9. 9. 2019, është shfuqizuar me urdhrin nr. 32, datë 26.1.2021 të cilin e gjeni në linkun e mëposhtëm:	Përfunduar	0

				https://qbz.gov.al/eli/urdher/2021/01/26/32/212-cc614-84b9-48c9-81c2-6da862abc13b;q=urdher%20nr%20311,%20dt.%209.%209.%202019		
71	11.11.2022	<p>Kërkesë për informacion: 1: Dëmtimi i bjeshkëve të këtij rrethi sikurse janë Doberdoli, Sylbica etj, duke kryer ndërtime pa leje dhe pa kriter, duke e kthyer terrenin në hekur dhe beton, hapja e rrugëve pa projekt, duke dëmtuar sipërfaqet e gjelbërta me bar e atë pyjor, tapetin e barit si pasojë edhe shkatërrimin e sipërfaqeve të tëra nga erozioni</p> <p>2: Dëmtimi i luginës së Valbonës, duke kryer ndërtime pa leje dhe pa kriter, duke kthyer terrenin në hekur dhe beton, hapja e rrugëve pa projekt, duke dëmtuar sipërfaqet e gjelbërta me bar e atë pyjor, tapetin e barit si pasojë edhe shkatërrimin e sipërfaqeve të tëra nga erozioni</p>	23.11.2022	<p>Deleguar dhe kthyer përgjigje nga AKZM në rrugë zyrtare:</p> <p>Bjeshkët e Dobërdolit dhe Sulbicës ku janë kryer ndërtime, sipas referencës tuaj, aktualisht janë brenda Parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” shpallur me VKM-në Nr. 59, datë 26.01.2022 “Për shpalljen e ekosistemeve malore parqe kombëtare kategoria e II”. Referuar kësaj VKM-je nga data e shpalljes e deri tani kjo sipërfaqe administrohet nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Kukës, mbështetur në ligjin nr 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.</p> <p>Nga viti 1998-2015 kjo sipërfaqe është administruar nga Ish Drejtoria e Shërbimit Pyjor Tropojë.</p> <p>Me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të bashkive” këto sipërfaqe i ka administruar bashkia Tropojë, të cilat i ka</p>	Përfunduar	0

